

UNIVERSITETI I EJL
ЈИЕ УНИВЕРЗИТЕТ
SEE UNIVERSITY



Fakulteti Administratës Publike dhe Shkencave Politike
Јавна администрација и политички науки
Public Administration and Political Sciences

STUDIMET PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTE

KANDIDATI:

Astrit Gjocaj,BA

MENTORI:

Dr.Sc.Memet Memeti

Tetovë, Shtator, 2016



STUDIMET PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTE

TEZA

POLITIKA PUBLIKE NË SFERËN E MIRËQENIES SOCIALE (R. KOSOVËS-R.SHQIPËRISË)

KANDIDATI:

Astrit Gjocaj,BA

MENTORI:

Dr.sc.Memet Memeti

Tetovë, Shtator, 2016

Abstrakt

Pasi që në ditët e sotme politikat sociale po bëhen çdo ditë e më të rëndësishëm për një shtet, gjithashtu po u kushtohet rëndësi e veçantë sigurimit dhe zhvillimit të shërbimeve sociale të vendit . Prandaj qëllimi kryesor i këtij punimi është analiza dhe krahasimi i politikave sociale dhe mirëqenies në mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

Mirëpo , rëndësi e veçant i është kushtuar edhe studimit për shërbimet sociale në Kosovë.

Ku studimi i paraqitur në këtë material përmbledh , studimin e realizuar në lidhje me shërbimet sociale në shtetin e Kosovës. Dhe sipas studimit kemi të dhënat e gjetura se qytetarët e shtetit të Kosovës kanë dëgjuar për politikat sociale dhe mirëqenien ,mirëpo nuk janë të kënaqur me shërbimet sociale në Kosovë sepse sipas tyre investimi i qeverisë në shërbimet sociale në Kosovë është investim i ulët edhe pse këto shërbime ndikojnë në cilësinë e jetës së qytetarëve. Arsye e Kosovës në ngecje me zhvillimin e shërbimeve sociale është mungesa e institucione të pavarura që mirren me shërbimet sociale dhe menaxhimi jo i mirë i shërbimeve sociale në vend. Dhe për të pasur zhvillim në shërbimet sociale duhet të përmirësohet gjetja e burimëve financiare që ndihmojnë në zhvillimin e shërbimeve financiare dhe përkushtim politik ndaj sigurimit të shërbimeve sociale.

Fjalët kyçe : Politikë ,Politika sociale, Mirëqenia , Shërbimet sociale.

Abstract

Since nowadays social policies are becoming every day more important for a country, it is also being given special attention to security and social services development of the country. Therefore the main purpose of this paper is to analyze and compare the social and welfare policies between Kosovo and Albania sells.

But the importance of particular was paid to research the market for social services in Kosovo.

Where the study presented in this paper summarizes research conducted in connection with social services in the state of Kosovo. And according to the study have the data found that the citizens of the state of Kosovo have heard of social policy and welfare, but are not satisfied with social services in Kosovo because by their government investment in social services in Kosovo is the investment low, although these services affect the quality of life of citizens. Reason of Kosovo standoff with the development of social services is the lack of independent institutions dealing with social services and improper management of social services in the country. Rich and developing social services should be improved finding financial resources to assist in the development of financial and political commitment to the provision of social services.

Key words: Policy ,Social policy, granted the ,Social Services.

Deklaratë	I
Abstrakt	II
Falenderime	III
Dedikim	IV
Tabela e Përmbajtjes	V
Lista e Tabelave	VI
Lista e Grafikëve	VII
Lista e Figurave	VIII
Lista e Shtojcës	IX
Lista e Shkurtesave	X

1.0.HYRJE.....	13
1.1.QËLLIMI	14
1.2.OBJEKTIVAT	14
1.3.STRUKTURA E PUNIMIT.....	15

KAPITULLI -I-PASQYRË E PËRGJITHSHME E POLITIKËS SOCIALE DHE MIRËQENIES

2.0.Hyrje.....	17
2.1.Historia e Politikave Sociale.....	18
2.2. Kuptimi i Politikave Sociale.....	19
2.3. Rëndësia e Politikave Sociale për një shtet	21
2.4. Mirëqenia.....	23
2.4.1. Llojet e Mirëqenies.....	24
2.5. Rreth Shërbimeve Sociale.....	25
2.6. Përfundim	26

**KAPITULLI -II- KRAHASIMI I MIRËQENIES SOCIALE-PENSIONET
(REPUBLIKA E KOSOVËS DHE REPUBLIKA E SHQIPRIË)**

3.0.Hyrje.....	28
3.1. Mirëqenia Sociale – Pensionet në Republikën e Kosovës.....	29
3.1.1. Llojet e Pensioneve në Republikën e Kosovës	30
3.1.2. Përshkrimi i Llojeve të Pensionit të Republikës së Kosovës.....	31
3.2. Mirëqenia Sociale – Pensionet në Republikën e Shqipërisë.....	35
3.2.1.Llojet e Pensioneve në Republikën e Shqipërisë	36
3.2.2.Përshkrimi i Llojeve të Pensionev të Republikës së Shqipërisë	37
3.3.Krahasimi i Mirëqenies Sociale-Pensioneve (R.Kosovës-R.Shqipërisë).....	41
3.4.Përfundim	48

**KAPITULLI -III- KRAHASIMI I SHËRBIMEVE SOCIALE (REPUBLIKA E
KOSOVËS DHE REPUBLIKA E SHQIPRIË)**

4.0.Hyrje.....	52
4.1.Shërbimet Sociale në Republikën e Kosovës	53
4.1.1.Llojet e shërbimeve sociale të ofruar nga Republika e Kosovës	54
4.2.Shërbimet Sociale në Republikën e Shqipërisë	58
4.2.1. Llojet e shërbimeve sociale të ofruar nga Republika e Shqipërisë	59
4.3.Krahasimi i Shërbimeve Sociale (R.Kosovës dhe R.Shqipërisë)	60
4.4.Përfundim	61

KAPITULLI -IV- STRUDIMI EMPIRIK

5.0. Hyrje.....	63
5.1. Metoda e studimit.....	64
5.2. Zgjedhja e mostrës së studimit.....	64
5.3.Pyetjet kërkimore	65
5.4. Formulimi i Hipotezave.....	66
5.5. Rezultatet nga Studimit Empirik.....	67
5.6. Përfundim nga Studimi Empirik	85

KAPITULLI-V-KONKLUKIME DHE REKOMANDIME

6.0.Hyrje.....	86
6.1. Vërtetimi/Testimi i Tipotezave	87
6.2. Konkludime të përgjithshme.....	88
6.3.Përfundim nga studimi empirik	91
6.4.Rekomandime	93
6.5. Referencat	95
6.6.Shtojca	99
6.6.1. Pyetësor i studimit për shërbimet sociale në shtetin e Kosovës.....	99
6.6.2, Tabela e rezultatëve nga studimi për shërbimet sociale (numri i të anketuarve , dhe të dhënat në përqindje)......	102

LISTA E GRAFIKAVE

Grafiku 1.0. Gjinia e të anketuarve. -----	67
Grafiku 2.0. Mosha e të anketuarëve. -----	68
Grafiku 3.0. Arsimimi i të anketuarve. -----	69
Grafiku 4.0. statusi i punës i të anketuarve. -----	70
Grafiku 5.0. Të hyrat familjre e të anketuarve. -----	71
Grafiku 6.0 Qyteti ku jetojnë të anketuarit. -----	72
Grafiku 7.0 Informimi i qytetarëve për politikat sociale dhe mirëqenien. -----	73
Grafiku 8.0 Mendimi i qytetarëve se a duhet shteti të informojë për politikat sociale dhe mirëqenien. -----	74
Grafiku 9.0 Mendimi i qytetarëve se a ka Kosova politika sociale. -----	75
Grafiku 10.0 Kënaqësia e qytetarëve me shërbimet sociale në Kosovë. -----	76
Grafiku 11.0 Investimi nga qeveria (i ulët, mesatar, i lartë). -----	77
Grafiku 12.0 Ndikimi i shërbimeve sociale në cilësinë jetës së qytetarëve. -----	78
Grafiku 13.0 Përgjegjës për investimet në shërbimet sociale. -----	79
Grafiku 14.0 Miratimi i politikës nga shteti për mbrojtjen e shërbimeve sociale. -----	80
Grafiku 15.0 Shërbimet sociale që ka investuar shteti më shumë. -----	81
Grafiku 16.0 Ekzistimi i institucioneve të pavarura që merren me ruajtjen, zhvillimin dhe sigurimin e shërbimeve sociale në mënyrë financiare. -----	82
Grafiku 17.0 Arsye e Kosovës në ngecje me zhvillimin e shërbimeve sociale. -----	83
Grafiku 18.0 Çka të përmirësoj qeveria që të kemi zhvillim në shërbimet sociale. -----	84

LISTA E TABELAVE

Table 1.0. Llojet e Pensioneve të ofruar nga Republika e Kosovës.....	30
Table 2.0. Llojet e Pensioneve të ofruar nga Republika e Shqipërisë.....	36
Table 3.0. Krahasimi i Pensionit Bazik të Republikës së Kosovës dhe Pensionit të Pleqërisë, Pension Pleqërie i Reduktuar të Republikës së Shqipërisë.	42
Table 4.0. Krahasimi i të drejtës për pension familjar të R.K. dhe pensionit familjar të R.SH.	43
Table 5.0. Krahasimi i të Drejtës në Pension Invalidor të Republikës së Kosovës dhe Pension Invaliditeti, Pension i Invaliditetit të Pjesshëm dhe Pension i Invaliditetit të Reduktuar të Republikës së Shqipërisë.....	45
Table 6.0. Pensionet e veçanta për Republikën e Kosovës.....	46
Table 7.0. Pensionet e veçanta për Republikën e Shqipërisë.....	47

LISTA E FIGURAVE

Figure 1.0. Llojet e Mirëqenies.....	24
---	----

LISTA E SHTOJCES

6.6.1. Pyetësor i studimit për shërbimet sociale në shtetin e Kosovës.....	99
6.6.2, Tabela e rezultateve nga studimi për shërbimet sociale (numri i të anketuarve , dhe të dhënat në përqindje).....	102

LISTA E SHKURTESAVE

R.K.	Republika e Kosovës
R.SH.	Republika e Shqipërisë
KMCAP	Komisioni Mjekesor i Caktimit të Aftësisë për Punë
H₁	Hipoteza parë
H₂	Hipoteza dytë
H₃	Hipoteza tretë
Page	Faqe
Seite	Faqe
KS	Kosova
AL	Albania
ISHSH	Institucioni i Shërbimeve Shoqërore.

Falenderime

Është kënaqësi dhe nder për mua që arrita në këtë fazë studimesh për të paraqitur falënderimet e mia , për të gjithë ata që më mbështetën gjatë rrugëtimit tim profesional dhe gjatë përfundimit të tezës së diplomës.

Falënderimet e mia të sinqerta për stafin akademik të Universitetit ,një falënderim i veçantë shkon për udhëheqësin tim në këtë punim Dr.Sc. Memet Memeti, i cili më ka përkrahur në vazhdimësi gjatë gjithë kohës me këshilla, sugjerime dhe ndihmë në aspektin profesional dhe shkencor . Faleminderit për besimin tuaj ndaj punës dhe angazhimit tim profesional .

Falenderoj të gjithë të intervistuarit të cilët ishin pjesë e studimit nëpërmjet plotësimit të pyetësorit.

Gjithashtu një falënderim i veçantë i përket familjes sime, pa ndihmën e tyre nuk do të kisha arritur deri këtu. Faleminderit shoqërisë , i falënderoj për mbështetjen dhe përkrahjen e tyre gjatë gjithë studimeve .

DEDIKIM

Punimin tim ia dedikoj të ndjerit babait tim (Avdyl Gjocaj) , i cili nuk gjendet më në mesin tonë, i cili gjithmonë më mbështeti, si dhe për dashurinë që mora prej tij kam arritur kwtu ku jam.

Kujtimi për të më dha forcë dhe kurajo të përfundoja me sukses këtë rrugëtim të gjatë akademik.

“Përkushtimi i juaj në të kaluarën është burim krenarie dhe frymzim i suksesëve të mia në të ardhmen”

Faleminderit Babë

1.0.Hyrje

Vitet e kaluara janë karakterizuar me ndryshime të vullshme në të gjitha sferat e jetës, duke filluar prej organizimit të jetës ekonomike e sociale .Politikat sociale luajn një rol të rëndësishëm në shumë aspekte të ndryshme të një shteti. Edhe pse politikat sociale gjatë zhvillimit nëpër vite , pësuan ndryshime të ndryshëm , mirëpo ndikimi i drejtpërdrejt në një shtet , roli dhe koncepti i saj mbetet i njëjtë edhe sot.

Si në çdo shtet tjetër edhe në Kosovë politikat sociale kanë ndikim të drejtpërdrejt në shumë aspekte, por nuk i ik ndikimit as shteti i Shqipërisë. Politikat sociale përveç që lidhen drejtpërdrejt me të drejtat e qytetarëve të shtetit të Kosovës e Shqipërisë, por për shtetin e Kosovës luan një rol të rëndësishëm , pasi që përmirësimi i këtyre politikave është kusht që Kosova të jetë pjesë e Bashkimit Evropian . Ngjarjet e ndryshme të pafavorshëm të politikave që ndodhin në shumë vende, sidomos në Kosovë dhe Shqipëri, krijuan prapambetje në shumë drejtime , veçmas në mbështetje të politikave sociale.

Strategjitë e mirfillta të mbrojtjes sociale në të dy shtetet kanë filluar shumë vonë dhe përgjatë viteve të fundit ajo është përmirësuar dukshëm , megjithatë problematikë për të dy shtetet mbetet mos zbatimi i plotë i kuadrit ligjor.

1.1. Qëllimi

Qëllimi kryesor i këtij punimi është analiza dhe krahasimi i politikave sociale dhe mirëqenies në mes shteteve Kosovë-Shqipëri. Mirëpo, rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe studimit për shërbimet sociale në Republikën e Kosovës.

1.2. Objektivat

Si objektiva për të arritur në realizimin e qëllimit të studimit, janë formuluar objektivat prej të cilave synohet përmbushja e qëllimit të studimi si:

- I. Rishikimi i literaturës për politikat sociale dhe mirëqenien;
- II. Mirëqenia Sociale- Pensionet (Republika e Kosovës-Republika e Shqipërisë).
- III. Shërbimet Sociale (Republika e Kosovës-Republika e Shqipërisë).
- IV. Studimi Empirik, analiza e të dhënave nga studimi në Republikën e Kosovës.
- V. Konkludimet dhe Rekomandimet se çka duhet përmirësuar për të ardhmen që qytetarët të jenë të kënaqur me shërbimet sociale.

1.3.Struktura e Punimit

Struktura e punimit është e përbërë në pesë kapituj.

Pjesa hyrjes në këtë pjesë tregohet në përgjithësi hyrje në punim, qëllimi i punimit duke specifikuar objektivat që do përdoren për realizimin e punimit. Gjithashtu në këtë pjesë shpjegohet edhe struktura e punimit.

Kapitulli i (I) “Hyrje në Politikat Sociale dhe Mirëqenien”. Në këtë kapitull shqyrtohet literatura e shfrytëzuar në lidhje me politikat sociale dhe mirëqenien, historia e politikave sociale, kuptimi i politikave sociale, mirëqenies dhe rreth shërbimeve politike.

Kapitulli i (II) ”Krahasimi i Mirëqenies sociale – Pensionet (R.Kosovë-R.Shqipëri)”. Në kapitullin e dytë, shpjegohen llojet e pensioneve në Republikën e Kosovës dhe Republikën e Shqipërisë dhe bëhet krahasimi i Mirëqenies sociale-pensionit (R.Kosovës dhe R.Shqipërisë)

Kapitulli i (III) ”Krahasimi i Shërbimeve Sociale (R.Kosovë-R.Shqipëri)”. Në kapitullin e tretë, përshkruhen shërbimet sociale të ofruar nga R.Kosovës dhe R.Shqipërisë dhe bëhet krahasimi i shërbimeve sociale në mes të R.Kosovës dhe R.Shqipërisë .

Kapitulli i (IV) “Studimi Empirik”. Në kapitullin e katërt flitet për metodat e studimit, prej qëllimit të studimit e deri tek rezultatet e studimit dhe formulimin e hipotezave .

Kapitulli i (V) “Konkludime dhe rekomandime”. Në këtë kapitull janë përfshirë kryesisht konkludimet dhe rekomandimet në bazë të temës, ku konkludimet ndahen në 3 pjesë: Pjesa e parë përfshinë konkludimet në vërtetimin e hipotezave; Pjesa e dytë përfshinë konkludimet e përgjithshme në bazë të materialit dhe pjesa e tretë përfshinë konkludimet nga rezultatet e studimit. Në kapitullin e pestë janë edhe rekomandimet të cilat janë nxjerr në bazë të të dhënave nga studimi, ndërsa referencat janë argumente se nga e kemi huazuar literaturën dhe shtojcën ku është vendosur pyetëtori dhe tabela me numrin e të anketuarve pjesëmarrës.

Deklaratë mbi origjinalitetin e punimit

Unë Astrit Gjocaj deklaroj se punimi i punuar për tezë të diplomës së masterit është shkruar nga unë dhe se si i tillw është rezultat i punës sime dhe se ky punim nuk përmban asnjë material që është marrë apo që është shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe referuara.

Po ashtu deklaroj se pjesët që nuk janë të cituara, nuk janë botuar apo publikuar më parë nga askush tjetër dhe as nuk janë prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim.

©Copyright, Astrit Gjocaj

Të gjitha të drejtt të rezervuara

2016

KAPITULLI I. PASQYRË E PËRGJITHSHME E POLITIKËS SOCIALE DHE MIRËQENIES

2.0.Hyrje

Nw kwtw kapitull jap një vështirim të përgjithshëm të literaturës së politikës sociale dhe mirëqenies. Rishikimi i literaturës organizohet sipas temave që vlerësohen si më të rëndësishme për të kuptuar politikën sociale dhe mirëqenien. Aspekti i rishikimit të literaturës do të na mundësojë të shpjegojmë historinë e politikave sociale, përshkrim të qartë të koncepteve dhe termave të politikës sociale dhe mirëqenies dhe rëndësia e politikave për një shtet dhe shërbimet sociale, duke marrë thelbin nga literatura dhe publikimet e autorëve të ndryshëm.

Objektivat e këtij kapitulli janë :

1. Vështirim i përgjithshëm i historisë së politikës sociale;
2. Nocioni *politikë* dhe përkufizimi i politikës sociale;
3. Rëndësia, ndikimi i politikave sociale për një shtet;
4. Mirëqenia dhe llojet e saj ;
5. Kuptimi i shërbimeve sociale;

2.1.Historia e Politikave Sociale

Mendohet që politikat sociale dhe mirëqenia zanafillën e kanë qysh në kohën e hershme, në shekullin e VI, ku shembull kemi ndërhyrjen e drejtpërdrejtë nga qeveria në përmirësimin e mirëqenies së njeriut, ku Umer ibn el-Hatab-së si kalifit i dytë i Islamit përdori, zeqatin dhe burime të tjera qeveritare për të ngritur pensionet, në ndihmë financiare, në përfitimet e fëmijëve, si dhe bursa të ndryshme për njerëz të komunitetit jomysliman.

Në Perëndim, ithtarët e planifikimit të shkencave sociale të tilla si sociolog Auguste Comte, dhe studiuesve sociale, të tilla si Charles Booth, kanë kontribuar në shfaqjen e politikës sociale në vendet e para të industrializuara pas revolucionit industrial.

Shembuj të tjerë të rëndësishëm në zhvillimin e politikës sociale janë shteti Bismarckian në shekullin e 19 në Gjermani, Politikat e sigurisë sociale në Shtetet e Bashkuara të futura nën rubrikën e New Deal midis 1933 dhe 1935, dhe Ligjit për Shërbimin Shëndetësor Kombëtar 1946 në Britani. Pra, fjala *politikë sociale* ka filluar të përdoret tashmë në të dyzetat e shekullit 19-të për çështje sociale në gjermani ku Gustav Schmoller dhe Adolf Wagner kanë mbajtur një séancë për “*çështje sociale*”¹ Politika sociale në shekullin e 21 është komplekse dhe në çdo shtet që është subjekt i qeverive lokale dhe kombëtare, si dhe ndikimi mbikombëtar politik. Për shembull, anëtarësimi në Bashkimin Evropian është i kushtëzuar me respektimin e shteteve anëtare të kapitullit Sociale të drejtës së Bashkimit Evropian dhe ligjet e tjera ndërkombëtare.²

¹ **Martin Bellerman**, “Sozialpolitik”, Eine Einführung für soziale, Seite 15.

² **Historia e politikave social**, Enciklopedia e lirë-https://en.wikipedia.org/wiki/Social_policy

2.2. Kuptimi i Politikave Sociale

Kemi shumë përkufizime, mendime të ndryshme rreth politikave sociale, ku politikat sociale kanë të paktën tre kuptime :³

- 1) Shumë e përkufizojnë politikën sociale si një prodhim që është një grumbull politikash, grumbull marrvëshjes dhe organizimin për të arritur politikën dhe ndikimin e politikës.
- 2) Politikën sociale e përkufizojnë si një dicitplinë apo fushë studimi (Alcoock 1998).
- 3) Politika sociale është një proces për veprim, për ta përmirësuar mirëqenien shoqërore .

Politika Sociale është studimi i mirëqenies së njeriut, më konkretisht politika sociale përfshinë studimin e marrëdhënieve shoqërore të nevojshme për mirëqenien e njeriut dhe sistemet në të cilat mund të promovohet mirëqenia .⁴

Ka kuptime të ndryshme në lidhje me termin *politikë sociale* ku Paul Spicker ka paraqitur dy kuptime në lidhje me termin politikë sociale. **Në kuptimin e parë**, politika sociale është veçanërisht e fokusuar në shqetësimin me shërbimet sociale dhe të shtetit social. **Në kuptimin e dytë**, më të gjerë, ajo qëndron për një sërë çështjesh që shtrihen përtej veprimeve të qeverisë. Më konkretisht, në shumë raste përfshinë politikat për shëndetësi, strehim, mirëmbajtjen e të ardhurave, arsim dhe punë sociale; nevojat dhe çështjet që ndikojnë në përdoruesit e shërbimeve, duke përfshirë varfërinë, pleqërinë, shëndetin, paaftësinë, politikën e familjes dhe shpërndarjen e mirëqenies.⁵

³ Alison McClelland, "What is Social Policy", Sample Only, Oxford University Press ANZ, Page 3.

⁴ Dean.H, Definition of social policy as a field of study, (2006), chapter 1, page 8

⁵ Spicker, Paul. "An introduction to Social Policy". Retrieved 21 May 2015., edition 3, pp 9

Emri "*politikë sociale*" është përdorur për t'iu referuar politikave të cilat qeveritë i përdorin për mirëqenie dhe mbrojtje sociale, për mënyrat në të cilat mirëqenia është zhvilluar në një shoqëri dhe në studimin akademik të subjektit. "*Politika sociale është studimi i shërbimeve sociale dhe të shtetit social. Politika sociale është një term që është aplikuar në fusha të ndryshme të politikës, zakonisht brenda një mjedisi qeveritar ose politik*".⁶

Departamente të ndryshëm, autorë dhe qendra të ndryshme deri më tani kanë dhënë dhjetëra e dhjetëra definicione në lidhje me atë se çka janë politikat sociale, ku për nga përmbajtja të gjitha janë të njëjta, mirëpo dallojnë në shtjellimin e ndonjë çështje më të hollësishme .

Departamenti i politikës sociale në shkollën ekonomike të Londrës, e përshkruan politikën sociale si:

"Një subjekt ndërdisiplinorë dhe të aplikuara në fjalë me analizën e përgjigjen e shoqërisë ndaj nevojës sociale", e cila kërkon të nxisë në studentët e tij një kapacitet për të kuptuar teorinë dhe prova të nxjerra nga një gamë të gjerë të disiplinave të shkencave sociale, duke përfshirë ekonominë, sociologjinë, psikologjinë, gjeografinë, historinë, ligjin, filozofinë dhe shkencat politike".⁷

Departamenti i politikave Sociale në Oksford që është fokusuar kryesisht në punën krahasuese ndërkombëtare, politikën sociale e përshkruan:

"Si veprime që ndikojnë në mirëqenien e anëtarëve të një shoqërie me formësimin, shpërndarjen dhe qasjen në mallra dhe burime në atë shoqëri".⁸

⁶P Spicker, Social policy: theory and practice, Policy Press 2014. ` edition III, part1pp.6

⁷ "*Welcome to the Department*". London School of Economics (LSE). Retrieved 21 May 2015.,

⁸ *Social Policy in Aotearoa New Zealand: A Critical Introduction* (2005) by Christine Cheyne, Mike O'Brien, & Michael Belgrave - Page 3

2.3. Rëndësia e Politikave Sociale për një shtet

Para se të njihen politikat sociale, para se autor të ndryshëm të shkruanin mendimin e tyre në lidhje me politikat sociale, nuk është ditur rëndësia e politikave sociale për një shtet . Dhe me zhvillimin e politikave ndër vite është kuptuar sa të rëndësishme janë politikat sociale për një shtet .

Politikat sociale janë shumë të rëndësishme për një shtet, sepse këto politika ndihmojnë shtetin në përmirësimin e disa aspekteve të ndryshme.

Ndikimi i politikave sociale për një shtet:⁹

1. Përmirëson cilësinë e jetës;
2. Edukimin;
3. Shtetësinë;
4. Kulturën;
5. Të ardhurat;
6. Ekonominë;

-Përmirëson cilësinë e jetës: Për shembull me anë të politikave sociale mund të sigurojnë një vend të sigurt të jetesës, mjedis të qëndrueshëm.

-Edukimin: Edukimi si një e drejtë themelore e të drejtave të njeriut llogaritet si instrument kyç i zhvillimit social dhe ekonomik, prandaj politikat sociale formulohen në atë mënyrë që të ndikojnë në përmirësimin e edukimit të një vendi. Edukimi është instrument i politikës sociale si dhe metodë e transmetimit në ndërtimin e normave dhe vlerave shoqërore.

⁹ Jose Vargas-Hernandez, Mohammad Reza Noruzi, Irani Farhad Nezhad Haj Ali. What is Policy, Social Policy and Social Policy Changing?. International Journal of Business and Social Science, 2011, 2 (10), pp.288

-Shtetësi: Politikat sociale kanë ndikim të drejtpërdrejtë në një shtet dhe shërbejnë në përmirësimin e luftës kundër varfërisë dhe parandalimin e saj. Po ashtu ndikojnë në përmirësimin e drejtësisë sociale, mbrojtje të rreziqeve të mëdha të ekzistencës . Gjithashtu me anë të politikës sociale mund të përmirësohet misioni i rishpërndarjes, ku garanton solidaritetin në mes qytetarëve të saj; misionin i aftësisë, ku përmes këtij misioni njerëzit i menaxhojnë shanset e tyre. Misioni rregullator lidhet me të drejtën e punës dhe vendosjen e rregullave dhe misionin mbrojtës që synon ruajtjen e dinjitetit p.sh. të drejtat themelore.

-Kultur: Kultura është faktori kyç brenda një shteti, ku shpesh herë llogaritet si një nga fushat themelore të një shteti, prandaj gjatë formulimit të politikave sociale duhet të ketë shumë kujdes, sepse një politikë e gabuar ndikon negativisht në kulturën e një shteti.

-Të ardhurat: Ndikon që të ardhurat të jenë të qëndrueshme dhe stabile, të mjaftueshme për plotësimin e kërkesave të qytetarëve.

-Ekonomi: Qeveritë mund të bëjnë ndryshime të politikave sociale në përgjigje të kushteve ekonomike. Shpesh politikat janë formuluar për rritjen ekonomike ose për të parandaluar pasojat negative ekonomike. Politikat sociale, për shembull, mund të përforcojnë politikën ekonomike, mund të jenë një instrument i ndryshimit shoqëror dhe një mjet për ruajtjen e rendit shoqëror të një shteti

2.4. Mirëqenia

Mirëqenia është një term jo shumë i kuptueshëm për të gjithë. Nëse do të pyesnim qytetarët se çka është mirëqenia sociale, askush nuk do të mund ta jepte një përkufizim që është e njëjtë dhe që e kuptojnë të gjithë . Pra, fjala mirëqenie është shumë e vështirë për tu kuptuar nga të gjithë.

Çka na shërben mirëqenia ?

Mirëqenia i shërben kryesisht interesave fizike dhe materiale të marrësit, ku interesat janë të lidhura edhe me nevojat e njerëzve, të cilat janë të përcaktuara shoqërisht dhe me atë që njerëzit duan.¹⁰

Mirëqenien mund ta kuptojmë edhe nga kuptimi i saj i gjerë, por edhe nga kuptimi i saj i ngushtë :¹¹

- a) *Në kuptimin e gjerë*, ideja e "mirëqenies" i referohet "mirëqenies", apo atë që është 'i mirë' për banorë.
- b) *Në kuptimin e ngushtë*, ajo mund të merret për t'iu referuar ofrimit të shërbimeve sociale, kryesisht kujdesit shëndetësor, strehimit, sigurimit social, arsimit dhe punës sociale.

^{10,11} **Paul Spicker** "Principles of social welfare" an introduction to thinking about the welfare state, First published 1988 by Routledge, page 8.

2.4.1. Llojet e Mirëqenies

Kemi dy lloje të mirëqenies:¹²




Figure 1.0. Llojet e Mirëqenies

A) Mirëqenia individuale i referohet asaj se çfarë është e mirë për njerëzit e për interesat e tyre. Feinberg përdor termin "*mirëqenie*" kur ju referohet interesave që ai i konsideron themelore, që përfshinë shëndetin fizik dhe energjinë, integritetin fizik dhe funksionimin. Mirëqenia individuale është një mjedis i tolerueshëm social dhe fizik (1980). Këto interesa janë 'bazë', sepse pa to një person nuk mund të jetë një person. Me fjalë të tjera, interesat e mirëqenies janë nevojat - artikuj që janë të thelbësore. Maslow (1943), si një psikolog e përshkruan mirëqenien në lidhje me një "hierarki" të nevojave, një seri e kushtet që duhet të plotësohen për secilin person. .

B) Mirëqenia Sociale. Pasi që mirëqenia individuale përfshinte vetëm interesat e një individi, mirëqenia sociale përbëhet thjesht nga më shumë individë.

¹² Paul Spicker " *Principles of social welfare* " an introduction to thinking about the welfare state, First published 1988 by Routledge, page 8-10.

2.5. Rreth Shërbimeve Sociale

Rreth asaj se çfarë janë shërbimet sociale ka shumë përkufizime. Deri më tani nuk ka pasur ndonjë përkufizim që tregon shkurt se çfarë janë shërbimet sociale, por secili nga ne ka përkufizimin se si i kupton shërbimet sociale .

- *Shërbimet Sociale*

Shërbimet sociale janë ndërhyrje që u bëhen individëve, familjeve dhe komuniteteve për të ndihmuar në uljen e varfërisë, për të zbutur rreziqet, për mirësuar përfshirjen dhe integrimin si dhe për të jetuar jetë të plota dhe të kënaqshme.

Në nivelin individual shërbimet sociale janë krijuar për t'u shërbyer të rriturve dhe fëmijëve në paaftësi, familjeve me vështirësi martesore, për të reduktuar pengesat në tregun e punës, njerëz të moshuar dhe shëndetligë, njerëz me sëmundje të gjata dhe kronike, fëmijë dhe të rritur në rrezik të abuzimit fizik dhe seksual; të rinj dhe të rritur me probleme me drogat dhe abuzimin me substancat; fëmijë të privuar nga kujdesi prindëror, të keqtrajtuar nga familjet ose në konflikt me ligjin.¹³

¹³ Republika e Kosovës “Strategjia për decentralizimin e shërbimeve në Kosove (2013-2017), zhvilluar nga komisioni këshillimor për politika për decentralizimin e shërbimeve sociale, Shtator 2012, faqe 7.

2.6. Përfundim

Në bazë të kapitullit të parë, vijmë në përfundim se politikat sociale dhe mirëqenia ka ekzistuar qysh në kohët e hershme dhe se zanafillën e ka në shekullin e VI. Ku si shembull mund ta paraqesim ndërhyrjen e drejtpërdrejtë nga qeveria në përmirësimin e mirëqenies së njeriut, ku Umer ibn el-Hatab-së si kalifit i dytë i Islamit përdori, zeqatin dhe burime të tjera qeveritare për të ngritur pensionet, ndihmat financiare, përfitimet e fëmijës, si dhe bursa të ndryshme për njerëz të komunitetit jomysliman. Shembuj të tjerë të rëndësishëm në zhvillimin e politikës sociale janë shteti Bismarckian në shekullin e 19 në Gjermani, Politikat e sigurisë sociale në Shtetet e Bashkuara të futura nën rubrikën e New Deal midis 1933 dhe 1935, dhe Ligjit për Shërbimin Shëndetësor Kombëtar 1946 në Britani. Dhe fjala politikë sociale ka filluar të përdoret tashmë në të dyzetat e shekullit 19-të për çështje sociale në gjermani ku Gustav Schmoller dhe Adolf Wagner kanë mbajtur një seancë për **“çështje sociale”**.

Departamenti i politikës sociale në shkollën ekonomike të Londrës, e përshkruan politikën sociale si: **“Një subjekt ndërdisiplinorë dhe të aplikuara në fjalë me analizën e përgjigjen e shoqërisë ndaj nevojës sociale”, dhe** Departamenti i politikave Sociale në Oksford që është fokusuar kryesisht në punën krahasues ndërkombëtare e përshkruan politikën sociale: **“Si veprime që ndikojnë në mirëqenien e anëtarëve të një shoqërie me formësimin, shpërndarjen dhe qasjen në mallra dhe burime në atë shoqëri”**.

Emri *“politikë sociale”* është përdorur për t’iu referuar politikave të cilat qeveritë i përdorin për mirëqenie dhe mbrojtje sociale, **“Politika sociale është studimi i shërbimeve sociale dhe të shtetit social. Politika sociale është një term që është aplikuar në fusha të ndryshme të politikës, zakonisht brenda një mjedis qeveritar ose politik”**

Përpos termit, kuptimit të politikave sociale, më herët nuk është ditur për rëndësinë që e kanë politikave sociale. Mirëpo, në këto vitet e fundit, po kuptohet më shumë rëndësia e politikave sociale. Politikave sociale kanë ndikim të drejtpërdrejtë, sepse me anë të politikave shteti po përmirëson cilësinë e jetës së qytetarëve, edukimin, shtetësinë, kulturën, të ardhurat dhe ekonominë.

Politikave sociale janë shumë të rëndësishme për një shtet, sepse këto politika ndihmojnë shtetin në përmirësimin e disa aspekteve të ndryshme.

Ndikimi i politikave sociale për një shtet: Përmirëson cilësinë e jetës, edukimin, shtetësinë, kulturën, të ardhurat dhe ekonominë.

Mirëqenia është një term jo shumë i kuptueshëm për të gjithë. Nëse do të pyesnim qytetarët se çka është mirëqenia sociale, askush nuk do të mund ta jepte një përkufizim që është e njëjtë dhe që e kuptojnë të gjithë. Mirëqenjen e kuptojmë në kuptimin e gjerë, ideja e "mirëqenies" i referohet "mirëqenien", apo atë që është 'i mirë' për banorë dhe në kuptimin e ngushtë, ajo mund të merret për t'iu referuar ofrimin e shërbimeve sociale, kryesisht kujdesit shëndetësor, strehimit, sigurimit social, arsimit dhe puna sociale.

Kemi dy lloje të mirëqenies:

a) **Mirëqenia individuale** që i referohet asaj se çfarë është e mirë për njerëzit e për interesat e tyre. Feinberg përdor termin "**mirëqenie**" kur ju referohet interesave që ai i konsideron themelore, që përfshin shëndetin fizik dhe energjinë, integritetin fizik dhe funksionimin.

b) **Mirëqenia Sociale.** Pasi që mirëqenia individuale përfshinte vetëm interesat e një individi, mirëqenia sociale përbëhet thjesht nga më shumë individë.

Shërbimet sociale janë ndërhyrje që u bëhen individëve, familjeve dhe komuniteteve për të ndihmuar në uljen e varfërisë, për të zbutur rreziqet, përmirësuar përfshirjen dhe integrimin si dhe për të jetuar jetë të plota dhe të kënaqshme.

KAPITULLI -II- KRAHASIMI I MIRËQENIES SOCIALE-PENSIONET (REPUBLIKA E KOSOVËS DHE REPUBLIKA E SHQIPRISË)

3.0.Hyrje

Siç e dimë të gjithë pensionet e një shteti janë shumë të rëndësishme për mirëqenien e qytetarëve të një shteti. Prandaj një gjë e tillë vlen edhe për Republikën e Kosovës dhe për qytetarët e Republikës së Shqipërisë. Prandaj ky kapitull përmban të dhënat në lidhje me pensionet e ofruar nga Republika e Kosovës dhe nga Republika e Shqipërisë. Synim i këtij kapitulli është krahasimi i pensioneve në mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e këtij kapitulli janë :

- I. Paraqitja e llojeve të pensioneve që ofrohen nga Republika e Kosovës dhe përshkrimi i këtyre pensioneve.
- II. Paraqitja e llojeve të pensioneve që ofrohen nga Republika e Shqipërisë dhe përshkrimi i këtyre pensioneve.
- III. Krahasimi i pensioneve në mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.
- IV. Pensionet që janë të Përbashkëta për Republikën e Kosovës dhe Republikën e Shqipërisë
- V. Pensionet që janë të veçanta për Republikën e Kosovës dhe Republikën e Shqipërisë.

3.1. Mirëqenia Sociale – Pensionet në Republikën e Kosovës

Korniza ligjore e Republikës Kosovës, Ligji, Nr.04/L-131 Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti, ku ky ligj parasheh të drejtën e pensionimit, për pension bazik të moshës, pension të aftësisë së kufizuar, pension të parakohshëm, pension invalidor të punës, pension familjar, beneficion për pensionin bazik të moshës, beneficion për pensionin e parakohshëm.¹⁴

Ky ligj rregullon dhe përcakton:¹⁵

1.1. pensionet bazike të moshës, pensionet kontribut paguese të moshës, pensionet e aftësisë së kufizuar, pensionet e parakohshme, pensionet familjare dhe pensionet invalidore të punës, si pensione të Shtyllës së I-rë të financuara nga shteti;

1.2. konsolidimin, harmonizimin dhe unifikimin e skemave pensionale të aplikueshme, të cilat aktualisht financohen nga Buxheti Shtetëror i Kosovës;

1.3. krijimin e një kornize ligjore të unifikuar për sigurimin e vazhdueshëm të këtyre pensioneve për shtetasit e Republikës së Kosovës si dhe për shtetasit e huaj, në përputhje me marrëveshjet bilaterale të sigurimeve sociale, të cilat i nënshkruan Republika e Kosovës me shtetet përkatëse;

1.4. kriteret dhe procedurat administrative të domosdoshme për njohjen e të drejtës në pension për pagesat e pensioneve;

Detyrat dhe Përgjegjësit e Departamentit përkatës për pensione¹⁶. Departamenti përkatës për pensione i Ministrisë, është përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e skemave pensionale të përcaktuara me këtë ligj.

Gjithashtu në bazë të këtij ligji për pensione në Republikën e Kosovës janë të përcaktuara me nene të ndryshme, kushtet që duhet plotësuara për të fituar ndonjë të drejtë nga pensionet, ku janë të paraqitura më poshtë në pjesën, 3.1.1. Llojet e Pensioneve në Republikën e Kosovës

¹⁴ Neni 2, Fushveprimi- Për skemat pensionale të financuar nga shteti, Kuvendi i Republikës së Kosovës, faqe 2

¹⁵ Neni 1, Qëllimi - Për skemat pensionale të financuar nga shteti, Kuvendi i Republikës së Kosovës, faqe 1

¹⁶ Neni 8, Detyrat dhe Përgjegjësit e Departamentit përkatës për pensione - Për skemat pensionale të financuar nga shteti, Kuvendi i Republikës së Kosovës, faqe 10.

3.1.1. Llojet e Pensioneve në Republikën e Kosovës

Sipas dispozitave të ligjit të Republikës së Kosovës personat që i plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara, sigurohen këto të drejta të pensioneve:¹⁷

Nr:	Llojet e Pensioneve në Kosovë
A.	E Drejta në pension bazik të moshës ;
B.	E Drejta në pension të aftësisë së kufizuar;
C.	E Drejta në pension të parakohshëm;
D.	E Drejta në pension invalidor të punës;
E.	E Drejta në pension familjar ;
F.	E Drejta në beneficion për pensionin bazik të moshës;
G.	E Drejta në beneficion për pensionin e parakohshëm;

Table 1.0. Llojet e Pensioneve të ofruar nga Republika e Kosovës.

Në tabelën 1.0. të lartë përmendur janë paraqitur llojet e pensioneve që paguhet nga Republika e Kosovës. Ku në bazë të tabelës kemi të drejtën për pension bazik të moshës, të drejtën në pension të aftësisë së kufizuar, të drejtën në pension të parakohshëm, të drejtën në pension invalidor të punës, të drejtën në pension familjar, të drejtën në beneficion për pensionin bazik të moshës dhe të drejtën në beneficion për pensionin e parakohshëm,

¹⁷ Neni 4, Të drejtat e përcaktuara me këtë ligj - Për skemat pensionale të financuar nga shteti, Kuvendi i Republikës së Kosovës, faqe 8.

3.1.2. Përshkrimi i Llojeve të Pensionit të Republikës së Kosovës

E Drejta në pension bazik të moshës;

Pensioni bazik i moshës ju paguhet të gjithë personave që janë shtetas të përhershëm të Republikës së Kosovës, të cilët posedojnë dokumentet e identifikimit dhe të cilat kanë mbushur moshën 65 vjeçare. Gjithashtu shfrytëzues të pensionimit bazik të moshës mund të jenë edhe shtetasit e huaj, me shtetin e të cilëve Republika e Kosovës, lidhë marrëveshje bilaterale ose ndërshtetërore për sigurimet sociale.¹⁸

E Drejta në pension të aftësisë së kufizuar;

Pensionimi i personave me aftësi të kufizuar do t'iu paguhet të gjithë personave shtetas të Republikës së Kosovës, që posedojnë dokumente të identifikimit dhe të cilët i kanë 18 deri 65 vjeç. Gjithashtu që të ketë të drejtën e pensionit me aftësi të kufizuar duhet të ketë personi .¹⁹

- a) Paaftësi të përhershme për një apo më shumë vjet nga dëshmia e mjekut, para se të aplikojë për pension;
- b) Paaftësi në kryerjen e punës;
- c) Paaftësia të vlerësohet nga mjeku, në kohëzgjatje prej 1, 3, 5 vjetësh;
- d) Gjithashtu për vazhdimin e pensionit pas kohëzgjatjes 1,3,5 vitesh, duhet të bëhet rivlerësimi mjekësor;

¹⁸ Neni 7, Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës për pensionin bazik të moshës, Projekt ligji për skemat pensionale të financuar nga shteti, Republika e Kosovës, faqe 9-10.

¹⁹ Neni 8, "Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension të aftësisë së kufizuar" Projekt ligji për skemat pensionale të financuar nga shteti, Republika e Kosovës, faqe 11-12.

E Drejta në pension të parakohshëm;

Të drejta për këtë lloj pensioni të parakohshëm kanë të gjithë të punësuarit në kompleksin “**Trepça**” dhe në minierat e tjera të Kosovës, nëse janë :²⁰

- a) Shtetas të Republikës së Kosovës;
- b) Nëse kanë moshën prej 50-65 vjeç;
- c) Nuk janë në mardhënie pune apo të vetëpunësuar;
- d) Dëshmi për ndërprerjen e mardhënies së punës, pa fajin e tyre;
- e) Janë të paafte në punë për shkak të gjendjes shëndetësore, nëse aftësia e punës është zvogëluar së paku për 50%;

E Drejta në pension invalidor të punës;

Të drejtën e këtij pensioni invalidor të punës kanë të gjithë ish shfrytëzuesit e pensionit invalidor të punës, e realizojnë të gjithë ish shfrytëzuesit e pensionit invalidor, nën moshën 65 vjeçare. Gjithashtu të drejtë kanë të gjithë të punësuarit, tek të cilët është shfaqur paaftësia e plotë për punë, si pasojë e lëndimit në punë apo e sëmundjes profesionale dhe duhet të përcaktohet nga në bazë të institucioneve publike të specializuar të mjekësisë së punës në Republikën e Kosovës.²¹

²⁰ Neni 9, “Kushtet dhe kriteret për njohjen e së drejtës për pension të parakohshëm” Projekt ligji për skemat pensionale të financuar nga shteti, Republika e Kosovës, faqe 13-14.

²¹ Neni 10, “Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës për pension invalidor të punës”, Projekt ligji për skemat pensionale të financuar nga shteti, Republika e Kosovës, faqe 15-16.

E Drejta në pension familjar;

Të drejtën e pensionit familjar e realizojnë të gjithë ish shfrytëzuesit e pensionit familjar të cilët janë nën moshën 65 vjeçare dhe të cilën realizimin e kësaj të drejte e dëshmojnë me vendim, sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe invalidor nr.011-24/83. Këtë të drejtë e realizojnë edhe antarët e ngushtë të familjes, të ish të siguruarit që kanë vdekur pas datës 01.01.1991 dhe që dëshmojnë që kanë 15 vite stazh të paguara të kontributeve, që ju kanë vdekur familjarët si pasojë e lëndimit në punë pa marr parasysh kohëzgjatjen e stazhit të punës. Të drejtën e pensionit familjar e realizojnë.²²

- a) Bashkëshorti/ja, prej moshës 55 vjeçare deri në 65, që kanë kurorë dhe dëshmojnë se janë të papunë. Bashkëshorti/ja nën moshën 55 deri 65 vjeçare, i shpallur invalid i përhershëm ose i paaftë për punë.
- b) Fëmijët, prej moshës 18 deri -26 vjeçare, nëse ofrojnë dëshmi përkatëse për vijimin e shkollimit të rregullt universitar.
- c) Shuma e pensionit familjar për një apo më shumë fëmijë rritet për 20% të pensionit bazik të moshës.
- d) Nëse fëmijët janë pa asnjë prindër, baza e pensionit familjar është në lartësi prej 70% e pensionit bazik të moshës.

²² **Neni 11**, “Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës për pension familjar”, Projekt ligji për skemat pensionale të financuar nga shteti, Republika e Kosovës, faqe 17-18.

E Drejta në beneficion për pensionin bazik të moshës;

Beneficioni i pensionit bazik të moshës dhe pensionit të parakohshëm, iu paguhet si shtesë të gjithë shfrytëzuesve aktual të pensionit bazik të moshës dhe shfrytëzuesve të pensionit të parakohshëm, të cilët ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor para datës 01.01.1999 sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83).²³

E Drejta në beneficion për pensionin e parakohshëm;

Parashtruesi i kërkesës për beneficionin e pensionit të parakohshme duhet të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; Nëse kanë moshën prej 50-65 vjeç; Nuk janë marrëdhënie pune apo të vetëpunësuar; Dëshmi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, pa fajin e tyre; Janë të paaftë në punë për shkak të gjendjes shëndetësore, nëse aftësia e punës është zvogëluar së paku për 50%. Gjithashtu të jenë të moshës 50 deri në 65 vjeçare dhe kenë humbur, mbi 50% aftësinë për punë, duhet të ketë së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet stazh pensional para datës 01.01.1999, prej të cilave së paku 7 vite 7 muaj të jenë stazh pune në Kosovë dhe të posedojë certifikatën/vlerësimin mjekësor për humbjen e mbi 50% të aftësisë për punë.²⁴

²³ *Neni 12, “Beneficioni për pensionin bazik të moshës dhe pensionin e parakohshëm”,* Projekt ligji për skemat pensionale të financuar nga shteti, Republika e Kosovës, faqe 19-21

²⁴ *Neni 9, “Kushtet dhe kriteret për njohjen e së drejtës për pension të parakohshëm”,* Projekt ligji për skemat pensionale të financuar nga shteti, Republika e Kosovës, faqe 13-15.

Neni 12, “Beneficioni për pensionin bazik të moshës dhe pensionin e parakohshëm”, Projekt ligji për skemat pensionale të financuar nga shteti, Republika e Kosovës, faqe 19- 21.

3.2. Mirëqenia Sociale – Pensionet në Republikën e Shqipërisë

Në bazë të kornizës ligjore të Republikës Shqipërisë, Ligji nr:7703,datë 11.05.1993 “ Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, ku ky ligj parasheh këto pensione: Pension pleqërie, pension pleqërie i reduktuar, pension pleqërie i reduktuar, pension invaliditetit, pension invaliditeti i pjesshëm, pension invaliditeti i reduktuar, pensioni familjar, të ardhura shtesë për përkujdesje, të ardhura shtesë për fëmijën në ngarkim, pagesë për vdekje.

Pensionet në Republikën e Shqipërisë hynë në kuadër të ligjit për sigurimet shoqërore dhe udhëhiqen nga Instituti i Sigurimet Shoqërore, ku sigurimet shoqërore përcaktojnë se cilët persona të fitojnë atë sigurim pensional në bazë të nevojës që shfaqin.²⁵

Gjithashtu në bazë të këtij ligjit për pensione në Republikën e Shqipërisë janë të përcaktuara nga nene të ndryshme, kushtet që duhet plotësuar për të fituar ndonjë të drejtë nga pensionet, ku janë të paraqitura më poshtë në llojet e pensioneve të ofruar nga Republika e Shqipërisë.

²⁵ **Instituti I sigurimëve Shoqërore** në zbatim të neveve 30-42 të kreut III-të, të ligjit Nr.7703, datë11.05.1993.

3.2.1.Llojet e Pensioneve në Republikën e Shqipërisë

Në bazë të ligjit për skemat pensionale të financuar nga Republika e Shqipërisë, llojet e pensioneve në Shqipëri janë:²⁶

Nr:	Llojet e Pensioneve në Shqipëri
A.	Pension pleqërie;
B.	Pension pleqërie i reduktuar;
C.	Pension invaliditetit;
D.	Pension invaliditeti i pjesshëm;
E.	Pension invaliditeti i reduktuar;
F.	Pensioni familjar;
G.	Të ardhura shtesë për kujdesje ;
H.	Të ardhura shtesë për fëmijën në ngarkim;
I.	Pagesë për vdekje;

Table 2.0. Llojet e Pensioneve të ofruar nga Republika e Shqipërisë.

Në tabelën 2.0. janë paraqitur llojet e pensioneve që ofrohen nga Republika e Shqipërisë dhe në bazë të tabelës kemi këto lloje të pensioneve : A) Pension pleqërie, B) Pension pleqërie i reduktuar, C) Pension invaliditetit, D) Pension invaliditeti i pjesshëm, E) Pension invaliditeti i reduktuar, F) Pensioni familjar, G) Të ardhura shtesë për përkujdesje, H) Të ardhura shtesë për fëmijën në ngarkim, I) Pagesë për vdekje.

²⁶ **KREU III, Neni 30, “PENSIONET”,** “Ligji për sigurimet shoqërore në Republikën e shqipërisë”, të ndryshuar, faqe 21-22.

3.2.2.Përshkrimi i Llojeve të Pensioneve të Republikës së Shqipërisë

Pension Pleqërie;

Personat që kanë të drejtë në këtë pension pleqërie të plotë, ku në moshën 65 vjeç është për burrat dhe 60 vjeç për gratë dhe nënat që kanë lindur 6 a më shumë fëmijë, të cilët janë rritur me shumë se 8 vjeç, kanë të drejtë të dalin në pension kur të mbushin moshën 50 vjeç dhe kanë 30 vjet sigurim.²⁷

Pension invaliditetit;

Personi që bëhet i paaftë merr pension invaliditeti, kur ka plotësuar periudhën minimale të sigurimit dhe për çdo arsye, përveç aksidentit në punë ose sëmundjes profesionale. Ai e merr këtë pension kur bëhet i paaftë: për çdo veprimtari ekonomike; kur ka gjymtime të forta dhe dëmtime fizike (duke përfshirë verbimin). Invaliditeti caktohet nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP). Periudha minimale e sigurimit për pension invaliditeti është sa 3/4 e diferencës së moshës së personit të siguruar në kohën që bëhet i paaftë dhe moshës 20 vjeç dhe në 5 vitet e fundit para lindjes së të drejtës të ketë së paku 12 muaj sigurim shoqëror. Personi, që është në kushtet e invaliditetit të plotë, por që nuk plotëson periudhën minimale të sigurimit, ka të drejtë për pension invaliditeti të reduktuar, në masën që rezulton nga raporti i periudhës së tij të sigurimit me periudhën e duhur për pension të plotë invaliditeti; Personi që përfiton pension për invaliditet, kur plotëson moshën, ka të drejtë të kërkojë pension pleqërie, nëse ky do të jetë më i favorshëm për të.²⁸

²⁷ KREU III, Neni 31, Ligji nr.7703.datë 11.05.1993 “Pension Pleqërie”, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,faqe 22.

²⁸ KREU III, Neni 35”Kushtet e përfitimit të penion invaliditetit, “Ligji për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,faqe 23..

Pension Pleqërie i Reduktuar;

Personat e siguruar kanë të drejtë për pension pleqërie të reduktuar, deri tre vjet para mbushjes së moshës së daljes në pension, vetëm kur kanë plotësuar vitet e sigurimit dhe nuk kryejnë veprimtari ekonomike si të punësuar, punëdhënës ose të vetëpunësuar. Pensioni i reduktuar është pjesë e pensionit të plotë dhe mbetet i reduktuar gjatë gjithë kohës së përfitimit.²⁹

Pensioni i invaliditetit të pjesshëm

I siguruari merr pension për invaliditet të pjesshëm, kur ka plotësuar periudhën minimale të sigurimit dhe kur për çdo arsye, përveç aksidentit në punë dhe sëmundjes profesionale, bëhet i paaftë të kryejë punën e fundit, por mund të punojë në kushte të veçanta pune. Shkalla e invaliditetit dhe puna që do të kryejë i siguruari, përcaktohet nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP); Pensioni i invaliditetit të pjesshëm është sa 50 përqind e pensionit të plotë të invaliditetit. Ai llogaritet në të njëjtën mënyrë si pensioni i plotë i invaliditetit.³⁰

Pension invaliditeti i reduktuar;

Personat e siguruar kanë të drejtë për pension pleqërie të reduktuar kur: a) kanë plotësuar jo më pak se 35 vjet sigurim; b) kanë mbushur moshën 62 vjeç për burrat e 57 vjeç për gratë; c) nuk kryejnë veprimtari ekonomike si të punësuar, punëdhënës ose të vetëpunësuar. Pensioni i reduktuar është pjesë e pensionit të plotë dhe mbetet i reduktuar gjatë gjithë kohës së përfitimit.³¹

²⁹ **KREU III, Neni 31/1, Ligji nr.7703.datë 11.05.1993** "Pension Pleqërie i reduktuar", "Ligji për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, faqe 22.

³⁰ **KREU III, Neni 37,** " Pensioni i invaliditetit të pjesshëm", "Ligji për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë ", të ndryshuar, faqe 24.

³¹ **KREU III, Neni 37/1,** " Pensioni i invaliditetit i reduktuar", "Ligji për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë ", të ndryshuar, faqe 24.

E ardhura shtesë për përkujdesje;

Kur përfituesi i një pensioni invaliditeti bëhet fizikisht ose psikikisht i paaftë dhe ka nevojë për një përkujdesje të vazhdueshme të një personi tjetër, atij i jepet një pagesë shtesë prej 15 përqind të bazës së vlerësuar neto. Nevoja për përkujdesje të vazhdueshme e një personi tjetër përcaktohet nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).³²

E ardhura shtesë për fëmijë në ngarkim;

Një person i siguruar i paaftë, që merr pension invaliditeti, dhe që ka në ngarkim fëmijët deri në moshën 18 vjeç ose kur këta studiojnë apo janë të paaftë për punë deri në moshën 25 vjeç, merr një të ardhur shtesë familjare për çdo fëmijë në masën 5 përqind të pensionit bazë, por jo më shumë se 30 përqind.³³

Pagesat për vdekje

Pagesa për vdekje i jepet: a) një personi të siguruar ose një pensionisti në rast vdekjeje të një anëtarit të familjes, që ai e ka në ngarkim; b) personit që u kujdes për personin e siguruar të vdekur, i cili pagoi shpenzimet e varrimit. Dhe pagesa për rast vdekje është e barabartë me 50 përqind të pagës minimale në shkallë vendi.³⁴

³² **KREU III, Neni 38,** ” *E ardhura shtesë për kujdesje* ”, “Ligji për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë ”, të ndryshuar,faqe 24.

³³ **KREU III, Neni 39,** ” *E ardhura shtesë për fëmijë në ngarkim* ”, “Ligji për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë ”, të ndryshuar,faqe 24-25.

³⁴ **KREU III, Neni 42,** ” *Pagesa për vdekje* ”, “Ligji për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë ”, të ndryshuar,faqe 26.

Pensioni familjar;

Personat që janë në ngarkim të personit që vdes, i cili kishte kushte për përfitimin e njërit nga llojet e pensioneve ose merrte pension, kanë të drejtë të marrin pension familjar; Pensioni familjar që përfiton është :

- a) E veja, kur provohet se ajo është: mbajtëse e një fëmije që ishte në ngarkim të të vdekurit, deri në moshën 8 vjeç; e paaftë për punë ose ka mbushur moshën 55 vjeç.
- b) Burri i ve, kur provohet se ai është: mbajtës i një fëmije që ishte në ngarkim të të vdekurit, deri në 8 vjeç; i paaftë për punë ose ka mbushur moshën 60 vjeç.
- c) Jetimi kur provohet që ai ishte në ngarkim të atij që vdiq dhe ka një moshë nën 18 vjeç, ose deri në 25 vjeç, nëse studion ose është i paaftë për punë, para se të arrijë moshat e mësipërme;
- d) Prindërit, kur kanë arritur moshën 65 vjeç ose janë të paaftë për punë, prindërit e prindërve, njerku e njerka, kur nuk kanë persona që detyrohen t'i mbajnë, nëse provohet se ata jetonin në të njëjtën familje me atë që vdiq, jo më pak se një vit. E veja dhe personi i ve humbasin të drejtën për pension familjar kur martohen.³⁵

³⁵ **KREU III, Neni 40,** ” *Pensioni Familjar, Kushtet e Përfitimit*, “Ligji për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, faqe 25.

3.3.Krahasimi i Mirëqenies Sociale-Pensioneve (R.Kosovës-R.Shqipërisë)

Në bazë të llojeve të pensioneve të Republikës së Kosovës në tabelën 1.0. dhe në bazë të llojeve të pensioneve të Republikës së Shqipërisë në tabelën 2.0. mund të vijmë në përfundim të krahasimit të llojeve të pensioneve në mes të dy shteteve :

Në këtë pjesë janë bërë krahasimet e pensioneve që janë në thelb të njëjta por që dallojnë për nga kushtet që duhet plotësuar :

- A. Krahasimi i pensionit bazik të Republikës së Kosovës dhe pensionit të pleqërisë, pension pleqërie i reduktuar i Republikës së Shqipërisë.
- B. Krahasimi i të drejtës për pension të Republikës së Kosovës dhe pensionit familjar të Republikës së Shqipërisë.
- C. Krahasimi i të drejtës në pension invalidor të punës të Republikës së Kosovës dhe pension invaliditeti, Pension invaliditeti i pjesshëm, pension invaliditeti i reduktuar i Republikës së Shqipërisë.

Pensionet që janë të veçanta për Republikën e Kosovës dhe Republikën e Shqipërisë.

a) Pensionet që janë të veçanta për Republikën e Kosovës

- E drejta në pension të aftësisë së kufizuar
- E drejta në pension të parakohshëm ;
- E drejta e beneficionit bazik të moshës;
- E drejta në beneficion për pensionin e parakohshëm;

b) Pensionet që janë të veçanta për Republikën e Shqipërisë:

- Të ardhura shtesë për kujdesje;
- E ardhura shtesë për fëmijët në ngarkim;
- Pagesat për vdekje;

A. Krahasimi i Pensionit Bazik të Republikës së Kosovës dhe Pensionit të Pleqërisë, Pension pleqërie i Reduktuar i Republikës së Shqipërisë.

Krahasimi i Pensioneve të ofruar nga Republika e Kosovës dhe Shqipërisë			
Nr.	Lloji i Pensioneve	Sheti	Përfundim nga Krahasimi i Pensioneve
1	Pension bazik i moshës ;	KS	Vijmë në përfundim se pensioni bazik i moshës në Republikën e Kosovës dhe pensioni i pleqërisë në Republikën e Shqipërisë, është i njëjti pension që ofrohet për qytetarët e vendit, Mirëpo që dallojnë për nga mosha e daljes në pension, ku për qytetarët e Republikës së Kosovës mosha e daljes në pension për të dy gjinitë është 65 vjeç, kurse për qytetarët e Republikës së Shqipërisë për burra është 65 dhe për gra 60 vjeç.
2	-Pension pleqërie ; -Pension pleqërie i reduktuar	AL	<p>-Dallojnë për nga kriteret që duhet plotësuar. ku në (R.SH) jepen pensioni i pleqërisë vetëm për qytetarët e vendit, kurse për (R.K) pensioni mund të jepet edhe shtetasve të huaj që R.K. ka lidh marrëveshje për sigurimet sociale.</p> <p>-Dallojnë për nga e drejta e marrjes të këtij pensioni ku në R.SH. u jepet e drejta e marrjes së pensionit edhe nënave që kanë lindur 6 e më shumë fëmijë, dalin në pension në moshën 50 vjeçe, kurse në R.K. Kjo e drejt e marrjes së pensionit nuk është.</p> <p>-Dhe dallim tjetër është se R.K. pensioni nuk është i ndarë, kurse në R.SH. përpos pensionit të pleqërisë kemi edhe pensionin e pleqërisë së reduktuar.</p>

Table 3.0. Krahasimi i Pensionit Bazik të Republikës së Kosovës dhe Pensionit të Pleqërisë, Pension Pleqërie i Reduktuar të Republikës së Shqipërisë.

B. Krahasimi i të drejtës për pension të Republikës së Kosovës dhe pensionit familjar të Republikës së Shqipërisë.

Krahasimi Pensioneve të ofruar nga Republika e Kosovës dhe Shqipërisë			
Nr	Lloji i Pensioneve	Sheti	Përfundim nga Krahasimi i Pensioneve
1	E drejta për pension familjar ;	KS	Ky lloje pensioni jepet nga të dy shtetet për qytetarët e vendit të tyre. Dhe arsye e këtij pensioni është në rast të vdekjes, familja të trashëgoj pensionin, që do të jetë edhe si lloj ndihme nga ana e shtetit.
2	Pension familjar;	AL	<p>Kanë të njejtën arsye por që dallojnë në kushtet që duhet ofruar :</p> <p>1. Në R.K. ky pension trashëgohet vetëm nëse i pensionuari që ka stazh 15 vjet të paguar të kontributeve, kurse në ligjin e R.SH. nuk është cekur ky stazh i pagimit të kontributeve. 2. Të drejtën e pensionit familjar e kanë: për R.K. Bashkëshorti/ja, prej moshës 55-65 vjeçare, që dëshmojnë që janë të pa punë ose invalid i përhershëm, kurse në R.SH. të drejtë e pensionit familjar kanë e veja që është mbajtëse e fëmijës deri në moshën 8 vjeç, është e papunë dhe ka mbushur 55 vjeç. Të drejtë ka edhe burri i ve, që ka mbushur moshën 60 vjeç, është i pa punë dhe tregon që është mbajtës i një fëmije nën moshën 8 vjeç.</p> <p>3. Të drejtën e pensionit familjar në R.K. kanë edhe fëmijët që janë të moshës 18 – 26 vjeç dhe nëse ofrojnë dëshmi të shkollimit. Dhe nëse fëmijët janë pa asnjë prindër, baza e pensionit është 70% e pensionit bazik të moshës dhe nëse ka më shumë se një fëmijë rritet për 20%, kurse në R.SH., kurse në R.SH. ky pension u takon fëmijëve vetëm nëse janë jetimë dhe të moshës deri 25 vjeç., të pa aftë për punë.</p>

Table 4.0. Krahasimi i të drejtës për pension familjar të R.K. dhe pensionit familjar të R.SH.

C. Krahasimi i të Drejtës në Pension Invalidor të Republikës së Kosovës dhe Pension Invaliditeti, Pension i Invaliditetit të Pjesshëm dhe Pension i Invaliditetit të Reduktuar të Republikës së Shqipërisë.

Krahasimi Pensioneve të ofruar nga Republika e Kosovës dhe Shqipërisë			
Nr.	Lloji i Pensioneve	Sheti	Përfundim nga Krahasimi i Pensioneve
1	E drejta në pension invalidor të punës;	KS	<p>Ky pension jepet nga shteti për qytetarët e vendit të saj, që nuk janë të aftë të jenë në marrëdhënie pune.</p> <p>Në Republikën e Kosovës e drejta e këtij pensioni i takon të gjithë personave që janë të paaftë për punë, gjithashtu personave që gjatë punës kanë shfaqur paaftësi të plotë në punë, gjatë ndonjë lëndimi apo e sëmundjes profesionale, Kurse në Republikën e Shqipërisë, Pension invaliditeti merr ai qytetar që është i paaftë për punë për çdo arsye, veç në aksident në punë ose sëmundjes profesionale.</p> <p>-Në Republikën e Kosovës ndryshon ligji i pensionit për invalid duke e krahasuar me Republikën e Shqipërisë në lidhje me paaftësinë, janë pensionet e ndarë në tre pjesë, a) Pension invaliditeti, b) Pension i invaliditetit të pjesshëm dhe pension i invaliditetit të reduktuar,</p>
2	Pension invaliditetit;	AL	
2,a	Pension i invaliditetit të pjesshëm;	AL	
2,b	Pension i invaliditetit të reduktuar;	AL	

		<p>-E drejta e pensionit invalidor të punës i takon të gjithë qytetarëve të moshës nën 65 vjeçare të Republikës së Kosovës, Kurse në Republikën e Shqipërisë periudha minimale për pension invaliditeti është sa $\frac{3}{4}$ e diferencës e moshës së personit që bëhet i paaftë dhe moshës 20 vjeçe, pastaj kur personi të ketë arrit në moshën që hyn në pension pleqërie, ka të drejtë të kërkesës për pension pleqërie.</p> <p>Në pensionin e invaliditetit të pjesshëm kanë të drejtë të përfitojnë për një kohë më pak se 35 vjet dhe më shumë se 15 vjet sigurim të pensionit të pjesshëm, kanë të drejtë për këtë sigurim të pjesshëm, kur të arrijë burri moshën 65 dhe gruja 60 vjeç, kurse për personat që kanë të drejtë sigurim të pensionit të reduktuar duhet të kenë të mbushur moshën 62 vjeç për burrat dhe 57 vjeç për gratë, që nuk kryejnë ndonjë veprimtari ekonomike, si të punësuar apo punëdhënës, ose të vetëpunësuar</p>
--	--	--

Table 5.0. Krahasimi i të Drejtës në Pension Invalidor të Republikës së Kosovës dhe Pension Invaliditeti, Pension i Invaliditetit të Pjesshëm dhe Pension i Invaliditetit të Reduktuar të Republikës së Shqipërisë.

➤ **Pensionet të veçanta për Republikën e Kosovës dhe Republikën e Shqipërisë.**

a) Pensionet e veçanta për Republikën e Kosovës.

Nr	Lloji i Pensionit	Përshkrimi i Pensioneve
1	E drejta në pension të aftësisë së kufizuar;	<i>Ky pension u paguhet të gjithë personave shtetas të Republikës së Kosovës. U jepet personave 18- 65 vjeç dhe duhet të plotësojnë kushtet, të sjell dëshmi nga mjeku, të ketë paaftësi në kryerjen e punës, paaftësia të vërtetohet nga mjeku me kohëzgjatje 1,3 dhe 5 vitesh. Dhe në rast të aplikimit përsëri duhet të bëhet rivlerësimi i paaftësisë nga mjeku.</i>
2	E drejta në pension të parakohshëm;	<i>Në këtë pension kanë të drejtë të gjithë të punësuarit në kompleksin "Trepça", dhe minierat e tjera të Kosovës. Dhe duhet të jenë shtetas të R.K., të kenë moshën 50-65 vjeç, të mos jenë në marrëdhënie pune dhe puna e tyre e gjatë, gjatë punës në miniera aftësia e punës është zvogëluar për 50%.</i>
3	E drejta e beneficionit bazik të moshës;	<i>Është pagesë shtesë që u paguhet të gjithë shfrytëzuesve aktual të pensionit bazik të moshës dhe shfrytëzuesve të pensionit të parakohshëm, të cilët ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve.</i>
4	E drejta në beneficion për pensionin e parakohshëm;	<i>Që të jetë pensionist i parakohshëm, duhet të ketë dëshmi të ndërprerjes së marrëdhënies së punës pa fajin e tyre. Të jenë shtetas të R.K. të jenë të moshës 50-65 vjeç, janë të paaftë për punë për shkak të gjendjes, të kenë stazh pune 15 vite, ku 7 vite të jenë stazh pune në Kosovë.</i>

Table 6.0. Pensionet e veçanta për Republikën e Kosovës.

a) Pensionet e veçanta për Republikën e Shqipërisë:

<i>Nr</i>	<i>Lloji i Pensionit</i>	<i>Përshkrimi i Pensioneve</i>
1	Të ardhura shtesë për kujdesje;	<i>Kur një qytetar i R.SH. është i paaftë ose bëhet i paaftë fizikisht apo psikikisht dhe ka nevojë për përkujdesje nga një person tjetër dhe i jepet paga duke u bazuar në nevojën që ka.</i>
2	E ardhura shtesë për fëmijët në ngarkim;	<i>Në rast se një familje është prindi i paaftë për punë, apo merr pension invaliditeti dhe ka nën përgjegjësi fëmijët deri në moshën 18 vjeç apo janë në studime deri në 25 vjeç, shteti i siguron një shumë shtesë, 5% të pensionit bazë, që do të ndihmojë familjes, mirëpo jo më shumë se 30%.</i>
3	Pagesat për vdekje;	<i>Pagesa për vdekje i jepet: a) një personi të siguruar ose një pensionisti në rast vdekjeje të një anëtarit të familjes, që ai e ka në ngarkim; b) personit që u kujdes për personin e siguruar të vdekur, i cili pagoi shpenzimet e varrimit. Dhe pagesa për rast vdekje është e barabartë me 50 % të pagës minimale në shkallë vendi.</i>

Table 7.0. Pensionet e veçanta për Republikën e Shqipërisë.

3.4.Përfundim

Në bazë të kornizës ligjore të Republikës Kosovës, Ligji, Nr.04/L-131 Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti, ku ky ligj parasheh të drejtën e pensionimit, për pension bazik të moshës, pension të aftësisë së kufizuar, pension të parakohshëm, pension invalidor të punës, pension familjar, beneficion për pensionin bazik të moshës, beneficion për pensionin e parakohshëm.

Dhe në bazë të kornizës ligjore të Republikës Shqipërisë, Ligji nr:7703,datë 11.05.1993 “ Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”,ku ky ligj parasheh këto pensione: Pension pleqërie, Pension pleqërie i reduktuar, Pension pleqërie i reduktuar, Pension invaliditetit, Pension invaliditeti i pjesshëm, Pension invaliditeti i reduktuar, Pensioni familjar, Të ardhura shtesë për përkujdesje, Të ardhura shtesë për fëmijën në ngarkim, Pagesë për vdekje.

Dhe duke i krahasuar këto pensione në bazë të kornizës ligjore të paraqitur nga Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë, e shohim se në thelb janë të njëjta por që dallojnë për nga kushtet që duhet plotësuar :

A) Krahasimi i pensionit bazik të Republikës së Kosovës dhe pensionit të pleqërisë, pension pleqërie i reduktuar i Republikës së Shqipërisë.

Pensionin bazik i moshës në Republikën e Kosovës dhe pensionin i pleqërisë në Republikën e Shqipërisë, është i njëjti pension që ofrohet për qytetarët e vendit, mirëpo që dallojnë për nga mosha e daljes në pension, ku për qytetarët e Republikës së Kosovës mosha e daljes në pension për të dy gjinitë është 65 vjeç, kurse për qytetarët e Republikës së Shqipërisë për burra është 65 dhe për gra 60 vjeç.

Dallojnë për nga kriteret që duhet plotësuar. ku në (R.SH) jepen pensioni i pleqërisë vetëm për qytetarët e vendit, kurse për (R.K) pensioni mund të jepet edhe shtetasve të huaj që R.K. ka lidh marrëveshje për sigurimet sociale.

Dallojnë për nga e drejta e marrjes të këtij pensioni ku në R.SH. u jepet e drejta e marrjes së pensionit edhe nënave që kanë lindur 6 e më shumë fëmijë, dalin në pension në moshën 50 vjeçe, kurse në R.K. Kjo e drejt e marrjes së pensionit nuk është.

Dhe dallim tjetër është se R.K. pensioni nuk është i ndarë, kurse në R.SH. përpos pensionit të pleqërisë kemi edhe pensionin e pleqërisë së reduktuar

B) Krahasimi i të drejtës për pension të Republikës së Kosovës dhe pensionit familjar të Republikës së Shqipërisë.

Ky lloje pensioni jepet nga të dy shtetet për qytetarët e vendit të tyre. Dhe arsye e këtij pensioni është në rast të vdekjes, familja të trashëgoj pensionin, që do të jetë edhe si lloj ndihme nga ana e shtetit. Kanë të njëjtën arsye por që dallojnë në kushtet që duhet ofruar :

1. Në R.K. ky pension trashëgohet vetëm nëse i pensionuari që ka stazh 15 vjet të paguar të kontributeve, kurse në ligjin e R.SH. nuk është cekur ky stazh i pagimit të kontributëve.
2. Të drejtën e pensionit familjar e kanë: për R.K. Bashkëshorti/ja, prej moshës 55-65 vjeçare, që dëshmojnë që janë të pa punë ose invalid i përhershëm, kurse në R.SH. të drejt e pensionit familjar kanë e veja që është mbajtëse e fëmijës deri në moshën 8 vjeç, është e papunë dhe ka mbushur 55 vjeç. Të drejtë ka edhe burri i ve, që ka mbushur moshën 60 vjeç, është i pa punë dhe tregon që është mbajtës i një fëmije nën moshën 8 vjeç.
3. Të drejtën e pensionit familjar në R.K. kanë edhe fëmijet që janë të moshës 18 – 26 vjeç dhe nëse ofrojnë dëshmi të shkollimit. Dhe nëse fëmijët janë pa asnjë prindër baza e pensionit është 70% e pensionit bazik të moshës dhe nëse ka më shumë se një fëmijë rritet për 20%, kurse në R.SH., kurse në R.SH. ky pension u takon fëmijëve vetëm nëse janë jetimë dhe të moshës deri 25 vjeç., të paaftë për punë

C) Krahasimi i të drejtës në pension invalidor të punës të Republikës së Kosovës dhe pension invaliditeti, Pension invaliditeti i pjesshëm, pension invaliditeti i reduktuar i Republikës së Shqipërisë.

Ky pension jepet nga shteti për qytetarët e vendit të saj, që nuk janë të aftë të jenë në marrëdhënie pune. Në Republikën e Kosovës e drejta e këtij pensioni i takon të gjithë personave që janë të paaftë për punë, gjithashtu personave që gjatë punës kanë shfaqur paaftësi të plotë në punë, gjatë ndonjë lëndimi apo e sëmundjes profesionale, Kurse në Republikën e Shqipërisë, Pension invaliditeti merr ai qytetar që është i paaftë për punë për çdo arsye, veç në aksident në punë ose sëmundjes profesionale.

Në Republikën e Kosovës ndryshon ligji i pensionit për invalid duke krahasuar me Republikën e Shqipërisë në lidhje me paaftësinë, janë pensionet e ndarë në tre pjesë, a) Pension invaliditeti, b) Pension i invaliditetit të pjesshëm dhe pension i invaliditetit të reduktuar,

Pensionet që janë të veçanta për Republikën e Kosovës

1. E drejta në pension të aftësisë së kufizuar: Ky pension u paguhet të gjithë personave shtetas të Republikës së Kosovës. U jepet personave 18- 65 vjeç dhe duhet të plotësojnë kushtet, të sjell dëshmi nga mjeku, të ketë paaftësi në kryerjen e punës, paaftësia të vërtetohet nga mjeku me kohëzgjatje 1,3 dhe 5 vitesh. Dhe në rast të aplikimit përsëri duhet të bëhet rivlerësimi i paaftësisë nga mjeku.

2. E drejta në pension të parakohshëm ; Në këtë pension kanë të drejtë të gjithë të punësuarit në kompleksin "Trepça", dhe minierat e tjera të Kosovës. Dhe duhet të jenë shtetas të R.K., të kenë moshën 50-65 vjeç, të mos jenë në marrëdhënie pune dhe puna e tyre e gjatë, gjatë punës në miniera aftësia e punës është zvogëluar për 50%.

3. E drejta e beneficimit bazik të moshës; Është pagesë shtesë që u paguhet të gjithë shfrytëzuesve aktual të pensionit bazik të moshës dhe shfrytëzuesve të pensionit të parakohshëm, të cilët ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve.

4. E drejta në beneficion për pensionin e parakohshëm; Që të jetë pensionist i parakohshëm, duhet të ketë dëshmi të ndërprerjes së marrëdhënies së punës pa fajin e tyre. Të jenë shtetas të R.K. të jenë të moshës 50-65 vjeç, janë të paaftë për punë për shkak të gjendjes, të kenë stazh pune 15 vite, ku 7 vite të jenë stazh pune në Kosovë.

Pensionet që janë të veçanta për Republikën e Shqipërisë:

1. Të ardhura shtesë për kujdesje; Kur një qytetar i R.SH. është i paaftë ose bëhet i paaftë fizikisht apo psikikisht dhe ka nevojë për përkujdesje nga një person tjetër dhe i jepet paga duke u bazuar në nevojën që ka.

2. E ardhura shtesë për fëmijët në ngarkim; Në rast se një familje është prindi i paaftë për punë, apo merr pension invaliditeti dhe ka nën përgjegjësi fëmijët deri në moshën 18 vjeç apo janë në studime deri në 25 vjeç, shteti i siguron një shumë shtesë, 5% të pensionit bazë, që do ti ndihmoj familjes, mirëpo jo më shumë se 30%.

3. Pagesat për vdekje; Pagesa për vdekje i jepet: a) një personi të siguruar ose një pensionisti në rast vdekjeje të një anëtari të familjes, që ai e ka në ngarkim; b) personit që u kujdes për personin e siguruar të vdekur, i cili pagoi shpenzimet e varrimit. Dhe pagesa për rast vdekje është e barabartë me 50 % të pagës minimale në shkallë vendi.

Sigurimi i këtyre pensioneve në Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Shqipërisë kontribuon në rritjen e mirëqenies sociale të vendit, pasi që me këto politika, po plotësohet një pjesë që qytetarët e vendit e ndjejnë mungesën që të jenë të barabartë dhe të gëzojnë një jetë më cilësore, pasi që janë qytetar të shtetit dhe duhet ta ndjejnë vetën pjesë të shtetit, e ti gëzojnë këto të drejta.

KAPITULLI -III- KRAHASIMI I SHËRBIMEVE SOCIALE (REPUBLIKA E KOSOVËS DHE REPUBLIKA E SHQIPËRISË)

4.0.Hyrje

Pasi që shërbimet sociale janë shumë të rëndësishme për mirëqenien e qytetarëve; pasi këto shërbime ofrohen nga ana e shtetit për qytetarët e saj, për plotësimin e nevojave dhe për përmirësimin e cilësisë jetësore Në këtë kapitull, shpjegohen shërbimet sociale të ofruar nga Republika e Kosovës dhe nga Republika e Shqipërisë. Qëllimi i punimit tonë në këtë kapitull është që të bëhet krahasimi i shërbimeve sociale të ofruara nga Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë.

Objektivat e këtij kapitulli janë :

- I.** Llojet e shërbimeve sociale që ofrohen nga Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë, si dhe përshkrimi i këtyre shërbimëve.
- II.** Krahasimi i shërbimeve sociale në mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

4.1.Shërbimet Sociale në Republikën e Kosovës

Republika e Kosovës përmes ofrimit të shërbimeve sociale, qytetarëve të saj u ndihmon në plotësimin e nevojave elementare për jetë, varësisht prej problemit që kanë. Edhe pse e dimë që viteve të fundit këto shërbime sociale kanë filluar të kenë zhvillim, të jenë më të avancuar në aspektin e ofrimit të këtyre shërbimeve, duke e krahasuar me vitet e më hershme, pasi që dihet gjendja ekonomike, politike dhe sociale në të cilën ka kaluar shteti i Kosovës viteve pas luftës.

Duke u bazuar në Kornizën ligjore të Republikës së Kosovës, paraqitet Ligji për shërbime sociale dhe Familjare, Ligji nr.02/0L-17 .³⁶

Ky Ligj përcakton dhe rregullon ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për personat në nevojë dhe familjet që janë në nevojë në Kosovë. Në rrethanat kur nuk ka përkrahje nga familja ose kur ajo nuk është e mjaftueshme për të siguruar mirëqenien e një individi, shteti ka për detyrë të ofrojë shërbime sociale dhe familjare për ata njerëz që ndryshe nuk do të ndihmoheshin në mënyrën, e cila do të respektonte dinjitetin e tyre si qenie njerëzore dhe të drejtat e tyre themelore të bazuara në legjislacionin e Kosovës dhe në konventat ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Përveç në rrethana të jashtëzakonshme të nevojës dhe të mbrojtjes, këto shërbime do t'u ofrohen personave në nevojë dhe familjeve në suaza të komunitetit e jo nëpër institucione rezidenciale.³⁷

Më poshtë janë paraqitur llojet e shërbimeve të përcaktuar nga Ligji nr.02/01-17 për shërbime dhe sociale dhe familjare.

³⁶ Neni 3, "Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare ", Ligji nr.02/L-17,Prill 2005. faqe 1.

³⁷ Neni 1, "Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare ", Ligji nr.02/L-17,Prill 2005. faqe 1

4.1.1. Llojet e shërbimeve sociale të ofruar nga Republika e Kosovës

1. Fëmijët a braktisur; Çdo fëmijë i moshës nën 18 vjeç i cili është i braktisur nga prindërit të cilët për shkaqe dhe arsye të ndryshme nuk kryejnë, apo nuk janë në gjendje t'i kryejnë obligimet, përgjegjësitë dhe të drejtat prindërore. Shërbimet sociale që ofrohen nga shteti për fëmijët e braktisur janë: Shërbimet për fëmijët e braktisur në spital, vendosja e fëmijëve në shtëpitë transitorë (të përkohshme), vendosja në strehim familjar, vendosja në adoptim vendor, vendosja në adoptim ndërkombëtar, bashkim familjar, kujdestari dhe vërtetim i atësisë.³⁸

2. Fëmijët jetim; Çdo fëmijë i cili i ka të dy prindërit e vdekur apo prindërit e të cilit/ cilëve, janë zhdukur dhe janë shpallur të vdekur nga Gjykata. Shërbimet sociale që ofrohen nga shteti për fëmijët jetim janë: vendosja e fëmijëve në shtëpitë transitorë, vendosja në strehim familjar tek të afërmit, vendosja në strehim familjar, vendosja në adoptim vendor, vendosja në adoptim ndërkombëtar, bashkim familjar dhe kujdestari.³⁹

3. Fëmijët e prindërve të penguar në kryerjen e detyrës prindërore; Fëmija i prindërve që kanë vështirësi ose janë të penguar në ofrimin e përkujdesjes adekuate apo mbikëqyrjen ndaj fëmijës për shkak të kushteve të jetesës, paaftësisë apo sëmundjeve fizike dhe mendore, i dhënë pas drogës, në vuajtje të dënimit etj. Shërbimet sociale që ofrohen nga shteti janë: Dhënia e mendimit dhe propozimit për institucionet e tjera (gjykatat, shkollën, çerdhet), mbrojtja e të drejtave pronësore, mbikëqyrja e edukimit dhe arsimimit, asistenca sociale sipas nevojës.⁴⁰

^{38, 39, 40} Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare, Nr.02/L-17,

Ligji për Familjen I Kosovës Nr:2004/32.

Intervista me Shyqeri Mehmeti " Drejtorin për shërbime sociale

4. Fëmijët e keqtrajtuar; Keqtrajtimi i çdo fëmije është akti i lëndimit trupor dhe shpirtëror dhe si i tillë cenon rëndë integritetin e fëmijëst. Varësisht nga format e mundshme në të cilat manifestohet kjo dhunë mundë të jenë:Psikike-emocionale, fizike, seksuale. Shërbimet sociale që ofrohen nga shteti janë: vendosja e fëmijëve në shtëpitë transitore, vendosja në strehim familjar tek të afërmit, vendosja në strehim familjar, bashkim familjar dhe kujdestari.⁴¹

5.Fëmijët me aftësi të kufizuar; Janë fëmijët nën moshën 18 vjeçare e që kanë ngecje të lindura në zhvillim fizik ose mendor ose janë të shkaktuar pas lindjes. Shërbimet sociale që ofrohen nga shteti janë: shërbimet e fëmijëve të braktisur në spital, përs hkas të aftësisë së kufizuar, vendosja e fëmijëve në shtëpi transitore, vendosja në strehim familjar, vendosja në adoptim vendor,vendosja në adoptim ndërkombëtar, bashkim familjar,kujdestari dhe vërtetim i atësisë.⁴²

6. Fëmijët e prindërve të shkurorëzuar; Janë fëmijët e prindërve të cilët kanë përfunduar procesin e ndarjes ose të shkurorëzimit. Shërbimet sociale që ofrohen nga shteti janë:dhënia e mendimit dhe propozimit për institucione tjera, besimi i fëmijëve, organizimi i kontakteve dhe mbikëqyrja e vizitave prindërore etj.⁴³

7. Fëmijët në punë; Angazhimi i fëmijëve në punë është një aktivitet që kryhet me dëshirë ose pa të, me qëllim përfitimi material e i shoqëruar me pasoja psiko -fizike e sociale. Shërbimi që ofron shteti është sigurimi i kujdestarisë sipas nevojës, strehimi familjar, strehim në shtëpitë transitore dhe asistencë sociale sipas nevojës.⁴⁴

^{41 42,43,44.} Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare, Nr.02/L-17,
Ligji për Familjen i Kosovës Nr:2004/32.
Intervista me Shyqeri Mehmeti ” Drejtorin për shërbime sociale”

8. Martesa e hershme e të miturve; Të miturit/at e moshës 16 deri 18 vjeçare, që cilët, dëshirojnë të hyjnë në martesë. Shërbimet sociale që ofrohen nga shteti për fëmijët që hyjnë në martesë të hershme janë: Vlerësimi për të miturit që kërkojnë të martohen (Këshillimi, marrja e deklaratave nga të miturit, prindërit e të miturit , përpilimi i raportit për gjykatën).⁴⁵

9. Fëmijët me sjellje asociale; Vështirësitë e shfaqura në kundërshtim me rregullat e shtëpisë, shkollës apo komunitetit si : grindje e tepruar, kërcënim ndaj të tjerëve, vrazhdësi apo dhunë e drejtuar drejt njerëzve apo kafshëve. Sjellje asociale për fëmijët më të rinj se 14 vjeç janë: shkatërrimi i pasurisë, vjedhje, posedim dhe përdorim i armës etj. Shërbimet sociale që ofrohen nga shteti për fëmijë me sjellje asociale janë: Risocializimi, vendosja në strehim familjar tek të afërmit, bashkim familjar dhe kujdestari .⁴⁶

10. Delinkuentët e mitur; Fëmijë delikuent të mitur konsiderohen fëmijët mbi moshën 14 vjeçare që kanë kryer shkelje të normave pozitive në fuqi (vepra penale ose kundërvajtëse) sipas legjislacionit në fuqi. Shteti ofron mbikëqyrje e shtuar nga Organi i Kujdestarisë, Risocializimi, vendeje në strehim familjar tek të afërmit, vendeje në strehim familjar, Sigurimi i programit rehabilitues psiko-social, bashkim familjar dhe kujdestaria.⁴⁷

11. Fëmijët viktimat të trafikimit : Trafikim me njerëz do të thotë rekrutimi, transportimi, transferimi ose strehimi me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës në forma të ndryshme si : mashtrim, rrëmbim etj. Dhe shërbimet e ofruar për viktimat e trafikuar janë: Kujdestaria për viktimat sipas nevojës, strehimi familjar, sigurimi i strehimit në shtëpitë e sigurta dhe asistencë sociale sipas nevojës.⁴⁸

^{45, 46, 47, 48} Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare, Nr.02/L-17,
Ligji për Familjen i Kosovës Nr:2004/32.
Intervista me Shyqeri Mehmeti ” Drejtor për shërbime sociale

12. Dhuna në familje; Dhuna në familje është akt i keqtrajtimit fizik, seksual ose psikologjik të një anëtari të familjes nga një anëtar tjetër me qëllime të kontrollimit. Keqtrajtimi brenda familjes e dëmton mirëqenien psikologjike, sociale, ekonomike, seksuale dhe psikike të viktimës. Dhe për personat që janë të viktimë të dhunës në familje, shteti ofron këto shërbime sociale ⁴⁹

13. Personat e moshuar pa përkujdesje familjare; të gjithë personat e moshuara mbi moshën 65 vjeçar në gjendje të nevojës sociale s të cilët mundë të dëshmojnë se kanë përkujdesje familjare, janë të braktisur apo të vetëm, dhe shteti ofron këto shërbime sociale : shtëpia, për persona të moshuar, shtëpitë e komunitetit për të moshuar, sigurimi i shërbimeve në institucionet e vendosjes, vizita në teren dhe vlerësimi, përgatitje të dokumentacionit, referimi në shëndetësi etj.⁵⁰

14. Të rriturit me nevoja të veçanta; Personat për shkaqe të nuk janë në gjendje që vetë të sigurojnë minimumin e mjeteve themelore për ekzistencë, dhe shteti ofron këto shërbime sociale: Referim në institucionet përkatëse për trajnim, Qendrën e shëndetit mendor, në shëndetësi, caktimi i kujdestarit në raste të veçanta, sesione këshilluese familjare etj.⁵¹

^{49,50,51} Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare, Nr.02/L-17,
Ligji për Familjen i Kosovës Nr:2004/32.
Intervista me Shyqeri Mehmeti ” Drejtor për shërbime sociale

4.2. Shërbimet Sociale në Republikën e Shqipërisë

*Në bazë të kornizës ligjore, Ligji Nr:9355 Ky ligj ka për qëllim:*⁵²

1. Të përcaktojë ndihmën dhe shërbimet shoqërore për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe të mundësive personale dhe ruajtjen e integritetit për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore.
2. Të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët dhe familjet, si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre.

Ky ligj rregullon marrëdhëniet e financimit e të ofrimit të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore në Shqipëri.⁵³ Shërbimi social shtetëror është institucion në varësi të Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale.⁵⁴ Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale është autoriteti përgjegjës për hartimin e politikave, të legjislationit, programimin e fondeve të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore, normave dhe standardeve të shërbimeve, si dhe kontrollin e zbatimit të tyre në të gjitha nivelet e strukturave, qendrore dhe vendore, në sektorin publik dhe privat.⁵⁵

Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale harton dhe paraqet pranë Ministrisë së Financave, nevojat për fonde nga buxheti për ndihmën ekonomike, pagesën për personat me aftësi të kufizuar dhe për shërbimet e përkujdesit shoqëror.⁵⁶

Më poshtë janë paraqitur llojet e shërbimeve sociale të përcaktuar nga Ligji Nr.9355, "Ligj për ndihmën dhe shërbimet sociale":

⁵² **Kreu I-Neni 1, Ligji nr:9355,** "Ligj për ndihmën dhe shërbimet sociale", datë 10.03.2005, faqe 17

⁵³ **Kreu I-Neni 2, Ligji nr:9355,** "Ligj për ndihmën dhe shërbimet sociale", datë 10.03.2005, faqe 17

⁵⁴ **Kreu V- Neni 26, Ligji nr:9355,** "Ligj për ndihmën dhe shërbimet sociale", datë 10.03.2005, faqe 25

⁵⁵ **Kreu V Neni 27, Ligji nr:9355,** "Ligj për ndihmën dhe shërbimet sociale", datë 10.03.2005, faqe 26

⁵⁶ **Kreu V Neni 28 Ligji nr:9355,** "Ligj për ndihmën dhe shërbimet sociale", datë 10.03.2005, faqe 26

4.2.1. Llojet e shërbimeve sociale të ofruar nga Republika e Shqipërisë

- 1. Përfitues të ndihmës ekonomike janë:**⁵⁷ a) Familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme; b) Jetimët mbi 25 vjeç, të papunë, të cilët nuk janë në institucione ose nën kujdestari; dhe c) Prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë. Dhe këto Ndihma ekonomike jepet në formën e një kësti mujor, në lekë, ose përfitimi mujor,. Masa mujore e ndihmës ekonomike në vlerë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.⁵⁸
- 2. Ndihamat për personat me aftësi të kufizuara:** Pagesa për personat me aftësi të kufizuara jepet në formën e një kësti mujor, në lekë. Masa e pagesës për këta individë dhe për kujdestarët e tyre përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Dhe Përfituesit duhet janë të klasifikuar me vendim të komisioneve mjekësore të aftësisë, në grupet e dyta të paaftësisë, humbasin të drejtën e pagesës së aftësisë së kufizuar, në çastin e punësimit të tyre.⁵⁹
- 3. Ndihamat e përkujdesit shoqëror:** Shërbime të përkujdesit shoqëror përfshijnë shërbimet që u ofrohen, individëve, familjeve në nevojë, që ju ndihmon për plotësimin e nevojave të tyre jetësore.⁶⁰

*Në Republikën e Shqipërisë shërbimet shoqërore ndahen sipas natyrës:*⁶¹ a) Shërbime të përkujdesit shoqëror; dhe b) Shërbime të përkujdesit shoqëror-mjekësor; Shërbime të përkujdesit social, Republika e Shqipërisë i ka të ndara kategoritë e shërbimeve sociale : Për fëmijët, për të moshuar, për qendra zhvillimi dhe për qendra transitore të emergjencave.⁶²

⁵⁷ Neni 5 Nr.9355,, "Ligj për ndihmën dhe shërbimet sociale", datë 10.03.2005,, Republika e Shqipërisë faqe 20

⁵⁸ NENI 10 Nr.9355,, "Ligj për ndihmën dhe shërbimet sociale", datë 10.03.2005,, Republika e Shqipërisë faqe 21

⁵⁹ NENI 11 Nr.9355,, "Ligj për ndihmën dhe shërbimet sociale", datë 10.03.2005,, Republika e Shqipërisë faqe 21

⁶⁰ Neni 13. Ligj.Nr.9355, Pika 1. "Ligj për ndihmën dhe shërbimet sociale" datë 10.03.2005,, Republika e Shqipërisë, faqe 22.

⁶¹ Neni 12, Ligj.Nr.9355,, "Ligj për ndihmën dhe shërbimet sociale", datë 10.03.2005,, Republika e Shqipërisë, faqe 21.

⁶² IPSH, Shërbimet sociale të ofruara, web; <http://www.sherbimisocial.gov.al/>

4.3.Krahasimi i Shërbimeve Sociale (R.Kosovës dhe R.Shqipërisë)

Duke u bazuar nga shërbimet që ofrohen nga Republika e Kosovës dhe nga Republika e Shqipërisë .Vijmë në përfundim se për nga mënyra se përse ofrohen këto shërbime sociale, kanë qëllime të njëjta, Pra ofrohen nga shtetet për qëllime të njëjta, për plotësimin e nevojave për familjet (individët), grupet që kanë nevojë, për plotësimin e nevojave jetësore.

Llojet e shërbimeve sociale të ofruar nga Republika e Kosovës janë: Fëmijët e braktisur, Fëmijët jetim, Fëmijët e prindërve të penguar në kryerjen e detyrës prindërore, Fëmijët e keqtrajtuar, Fëmijët me aftësi të kufizuar, Fëmijët e prindërve të shkurorëzuar, Fëmijët në punë,Martesa e hershme e të miturve; Fëmijët me sjellje asociale, Delinkuentët e mitur, Fëmijët viktimë të trafikimit, dhuna në familje, personat e moshuar pa përkujdesje familjare dhe të rriturit me nevoja të veçanta. Kurse nga Republika e Shqipërisë ofron shërbime si përfitues të ndihmës ekonomike ndihmat për personat me aftësi të kufizuara dhe ndihmat e përkujdesit shoqëror.

Shërbimet sociale në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, dallojnë për nga mënyra se si janë të formuluar këto politika. Në Republikën e Kosovës është Ligji i shërbimeve sociale dhe familjes Nr:02/01-17 që përfshinë të gjithë llojet e shërbimeve të ofruar, kurse në Republikën e Shqipërisë është Ligj për ndihmën dhe shërbimet sociale, nr 9355, datë 10.03.2005. Ku neni 6 i ligjit nr. 9355, paraqet përfituesit e shërbimeve sociale që i parasheh ky ligj.

Dallimi tjetër është se neni 12 i ligjit për ndihmën dhe shërbimet sociale nr. 9355 i Republikës së Shqipërisë, parasheh ndarjen e shërbimeve sipas natyrës, në shërbime të përkujdesit shoqëror dhe në shërbime të përkujdesit shoqëror-mjekësor.

Shërbimet sociale në Republikën e Kosovës, ofrohen prej entit social, kurse në Republikën e Shqipërisë ofrohet nga shërbimi social shtetëror (ISHSH), Shërbimi social shtetëror është institucion publik, në varësi të Ministrisë përgjegjëse për çështjet e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore.(Neni 26. Pika1,Ligj për ndihmën dhe shërbimet sociale). Dhe se ky institucion, i ndanë kategoritë e shërbimeve sociale : Për fëmijët, për të moshuar, për qendra zhvillimi dhe për qendra transitore të emergjencave.

4.4.Përfundim

Aktualisht në mes ligjeve të shteteve, nuk ka një përshkrim të njëjtë të shërbimeve sociale, mirëpo, këto shërbime mund të përafrohen për nga qëllimi se për çfarë ofrohen për personat që janë në nevojë, e cila do ju shërbej për plotësimin e nevojave themelore për një jetë më të mirë.,

Në bazë të kornizës ligjore të Kosovës, Ligji për shërbime sociale dhe Familjare, Ligji nr. 02/0L-1, përcakton dhe rregullon ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për personat në nevojë dhe familjet që janë në nevojë në Republikën e Kosovës. Gjithashtu në rrethanat kur nuk ka përkrahje nga familja ose kur ajo nuk është e mjaftueshme për të siguruar mirëqenien e një individi, shteti i Kosovës ka për detyrë të ofrojë shërbime sociale dhe familjare për personat në nevojë.

Llojet e shërbimeve sociale të ofruar nga Republika e Kosovës janë: Fëmijët e braktisur, Fëmijët jetim, Fëmijët e prindërve të penguar në kryerjen e detyrës prindërore, Fëmijët e keqtrajtuar, Fëmijët me aftësi të kufizuar, Fëmijët e prindërve të shkurorëzuar, Fëmijët në punë, Martesa e hershme e të miturve; Fëmijët me sjellje asociale, Delinkuentët e mitur, Fëmijët viktimë të trafikimit, dhuna në familje, Personat e moshuar pa përkujdesje familjare dhe të rriturit me nevoja të veçanta.

Të gjitha shërbimeve sociale të ofruar nga Republika e Kosovës, të lartpërmendura kanë për qëllim të përmirësojnë mirëqenien e qytetarëve, të rritë cilësinë e një jetese më të mirë, dha ta zbusë varfërinë për qytetarët që jetojnë në shtetin e Kosovës.

Në bazë të kornizës ligjore të Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr:9355, ka për qëllim të përcaktojë ndihmën dhe shërbimet shoqërore për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe të mundësive personale dhe ruajtjen e integritetit për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore. Të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët dhe familjet, si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre.

Republika e Shqipërisë ofron shërbimet sociale për qytetarët e saj në forma : si përfitues të ndihmës ekonomike duke ju ndihmuar familjeve që janë pa të ardhura, për fëmijët e pa punë, prindërve që kanë më shumë se dy fëmijë dhe nuk kanë kushte për t'iu ofruar një të ardhme. Ndihamat për personat me aftësi të kufizuara: këto ndihma jepen për personat me aftësi të kufizuara, në formë të pagesave që do t'iu ndihmojnë për nevojat themelore . Dhe Ndihamat e përkujdesit shoqëror: Shërbime të përkujdesit shoqëror përfshijnë shërbimet që u ofrohen, individëve, familjeve në nevojë, që ju ndihmon për plotësimin e nevojave të tyre jetësore

Shërbimet sociale në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, dallojnë për nga mënyra se si janë të formuluar këto politika. Në Republikën e Kosovës është Ligji i shërbimeve sociale dhe familjes Nr:02/01-17 që përfshinë të gjithë llojet e shërbimeve të ofruar, kurse në Republikën e Shqipërisë është Ligj për ndihmën dhe shërbimet sociale, nr 9355, datë 10.03.2005. Ku neni 6 i ligjit nr. 9355, paraqet përfituesit e shërbimeve sociale që i parasheh ky ligj.

Dallimi tjetër është se neni 12 i ligjit për ndihmën dhe shërbimet sociale nr.9355 i Republikës së Shqipërisë, parasheh ndarjen e shërbimeve sipas natyrës, në shërbime të përkujdesit shoqëror dhe në shërbime të përkujdesit shoqëror-mjekësor.

Shërbimet sociale në Republikën e Kosovës, ofrohen prej entit social, kurse në Republikën e Shqipërisë ofrohet nga shërbimi social shtetëror (ISHSH), Shërbimi social shtetëror është institucion publik, në varësi të Ministrisë përgjegjëse për çështjet e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore.(Neni 26. Pika 1, Ligj për ndihmën dhe shërbimet sociale). Dhe se ky institucion, i ndanë kategoritë e shërbimeve sociale : Për fëmijët, për të moshuar, për qendra zhvillimi dhe për qendra transitore të emergjencave

KAPITULLI -IV- STUDIMI EMPIRIK

5.0. Hyrje

Ky studim në këtë punim përfshinë mbledhjen dhe organizimin e fakteve empirike, formulimin e hipotezave, mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave në arritjen e konkluzioneve dhe rekomandimeve për shërbimet sociale.

Qëllimi i studimit është të jep një pasqyrë të plotë të opinionit të qytetarëve në lidhje me shërbimet sociale.

Objektivat e kapitullit –IV-studimit empirik janë:

1. Metoda e përdorur dhe mostra e zgjedhur për studim;
2. Paraqitja e pyetjeve kërkimore;
3. Formulimi i hipotezave ;
4. Paraqitja e rezultateve nga studimi(Me anë të grafikës);

5.1. Metoda e studimit

Gjatë përfundimit të studimit në këtë punim është përdorur metoda sasiore e mbledhjes së të dhënave dhe për të arritur përfundimin e këtij studimi është përdorur mënyra e studimit : intervista dhe për mbledhjen e të dhënave, është përgatitur një pyetësor si instrument studimi, ku pyetësi është përgatitur në mënyrë elektronike me anë të *Google Drive* dhe është shpërndarë me anë të email dhe rrjeteve sociale. ku kjo ka ndihmuar që më lehtë të bëhet testimi i hipotezave të parashtruara.

Koha e studimit : studimi është bërë në periudhën 19 prill -31 Maj.

5.2. Zgjedhja e mostrës së studimit

Metoda sasiore e mbledhjes së të dhënave përmban në vete analizën e të dhënave primare të mbledhura përmes pyetësorit, Madhësia e mostrës së deri në 500 është e përshtatshme për të kryer studimin . Por madhësia e mostrës së përdorur në punim është 628 qytetarë të shtetit të Kosovës.

5.3. Pyetjet kërkimore

Punimi synon që të paraqesë një opinion të përgjithshëm në lidhje me shërbimet sociale në shtetin e Kosovës. Por, për arritjen e qëllimit do të duhet të japim përgjigje në pyetjet kërkimore si më poshtë:

- A keni dëgjuar për politikat sociale dhe mirëqenien ?
- Nëse jo, a mendoni që shteti i Kosovës duhet të përdor, mjete të ndryshëm që të informojë qytetarët për politikat sociale dhe mirëqenien ?
- A mendoni që Kosova ka politika sociale ?
- Si qytetar a jeni të kënaqur me shërbimet sociale në Kosovë?
- A mendoni ju se qeveria e Kosovës në shërbimet sociale ka bërë investim të ulët, mesëm, të lartë?
- Shërbimet sociale të mirfillta të një vendi, a ndikojnë në cilësinë e jetës të qytetarëve?
- Kush duhet të jetë përgjegjës për investimet në shërbimet sociale ?
- A ka miratuar shteti juaj një politikë, duke deklaruar se i mbron shërbimet sociale të vendit ?
- Në cilat shërbime sociale mendoni që shteti ka investuar më shumë?
- A ka vendi juaj institucione të pavarura që mirren me ruajtjen, zhvillimin dhe sigurimin e shërbimeve sociale në mënyrë financiare?
- Cila është arsye që Kosova ka pas ngecje me zhvillimin e shërbimeve sociale?
- Çka duhet të përmirësoj qeveria ,që të kemi zhvillim në shërbime sociale ?

5.4. Formulimi i Hipotezave


H₁- Shërbimet sociale të mirëfillta janë parakusht për cilësinë e jetës së qytetarëve .

H₂- Qytetarët nuk janë të kënaqur me shërbimet sociale.

H₃. Shteti nuk investon sa duhet në shërbimet sociale dhe se për investimet në shërbimet sociale duhet të jenë përgjegjësi e pushtetit lokal.

5.5. Rezultatet nga Studimit Empirik


➤ Gjinia Juaj ?



Grafiku 1.0. Gjinia e të anketuarve.

Nga të dhënat e paraqitura më lartë në grafikun 1.0. kemi të paraqitur % (përqindjen) e të anketuarve, gjatë studimit për shërbimet sociale në shtetin e Kosovës .Përqindja e pjesëmarrjes të gjinisë femërore është 46 %, kurse pjesëmarrja e gjinisë mashkullore është 54 %.


➤ *Mosha e juaj?*



Grafiku 2.0. Mosha e të anketuarëve.

Në grafikun 2.0. kemi paraqitur moshën e të anketuarve, ku mosha pjesëmarrës në studim është: mosha 18-25 pjesëmarrës ishin 18.31 %, prej 26-35 pjesëmarrës ishin 12.10 %, prej moshës 36-45 ishin pjesëmarrës 67.83 %, dhe pjesëmarrës mbi 46 vjeç ishin 1.76 %.


➤ *Arsimimi juaj ?*



Grafiku 3.0. Arsimimi i të anketuarve.

Në grafikun 3.0. kemi paraqitur nivelin e arsimimit të qytetarëve që kanë marrë pjesë në studim për shërbimet sociale në shtetin e Kosovës. Ku nga grafika vërejmë se qytetarët që kanë marrë pjesë në studim i takojnë nivelit të arsimit fillor me 3.82 %, Arsimit të mesëm me 11.95 %, dhe 84.23 %, kanë nivel të arsimit të lartë.


➤ *Statusi juaj i punës ?*



Grafiku 4.0. statusi i punës i të anketuarve.

Në grafikun 4.0. kemi paraqitur statusin e punës të qytetarëve që kanë marrë pjesë në studim për shërbimet sociale në shtetin e Kosovës. Ku nga grafiku 4.0. vërejmë se përqindja e qytetarëve që kanë marrë pjesë në studim 46 % janë të punësuar, të papunë kanë deklaruar se janë 24 % e qytetarëve të anketuar, 30 % kanë deklaruar se janë student.


➤ *Të hyrat familjare ?*



Grafiku 5.0. Të hyrat familjre e të anketuarve.

Në grafikun 5.0. kemi paraqitur të hyrat familjare e të anketuarve, ku të hyrat familjare deri në 200 euro në muaj kanë deklaruar 21.49 % e të anketuarve, të hyrat familjare prej 201-400 euro në muaj kanë 65.12 % e të anketuarve, të hyrat familjare prej 401-600 euro në muaj kanë deklaruar 7.17 %, të hyrat familjare prej 601-800 euro në muaj kanë deklaruar 5.10 %, dhe të hyrat familjare mbi 800 euro në muaj kanë deklaruar 1.12 %. Nga të dhënat e paraqitura vërejtëm se përqindja më e lartë e të anketuarve kanë të hyra mujore prej 201-400 euro në muaj .


➤ *Qyteti ku jetoni?*



Grafiku 6.0 Qyteti ku jetojnë të anketuarit.

Nga të dhënat e paraqitura më lartë në grafikun 6.0. kemi të paraqitur qytetin e të anketuarve, gjatë studimit për shërbimet sociale në shtetin e Kosovës . Përqindja e qytetarëve pjesëmarrje më të lartë kemi nga qyteti i Prishtinës me 31.84 % , në qytetin e Ferizajt me 18.31 % , në qytetin e Gjakovës me 8.12 % , në qytetin e Prizrenit me 3.99 % dhe pjesëmarrja e qytetarëve në këtë anketë nga qytetet tjera është 35.67 % .


➤ *A keni dëgjuar për politikat sociale dhe mirëqenien ?*



Grafiku 7.0 Informimi i qytetarëve për politikat sociale dhe mirëqenien.

Në grafikun 7.0. kemi paraqitur rezultatet e studimit ne lidhje me pyetjen se a kanë dëgjuar për politikat sociale dhe mirëqenien, ku nga grafiku 7.0 kemi të dhënat përfundimtare ku vërejmë se 62 % e të anketuarve kanë dëgjuar për politikat sociale dhe mirëqenien, kurse 38% e tyre kanë deklaruar se nuk kanë dëgjuar për politikat sociale dhe mirëqenien .


- *Nëse jo, a mendoni që shteti i Kosovës duhet të përdor, mjete të ndryshëm që të informojë qytetarët për politikat sociale dhe mirëqenien ?*



Grafiku 8.0 Mendimi i qytetarëve se a duhet shteti të informojë për politikat sociale dhe mirëqenien.

Në pyetjen e parashtruar qytetarëve të anketuar se nëse nuk kanë dëgjuar për politikat sociale dhe mirëqenien, a mendoni që shteti i Kosovës duhet të përdor, mjete të ndryshëm që të informojë qytetarët për politikat sociale dhe mirëqenien, në grafikun 8.0 të paraqitur më lartë kemi rezultatet e studimit ku shihet se 100 % e qytetarëve të anketuar kanë deklaruar se shteti duhet ti informojë qytetarët e saj .


➤ *A mendoni që Kosova ka politika sociale ?*



Grafiku 9.0 Mendimi i qytetarëve se a ka Kosova politika sociale.

Në grafikun 9.0. është paraqitur mendimi i qytetarëve në lidhje se: A ka Kosova politika sociale dhe në bazë të informimit që kanë qytetarët 58.68 %,kanë deklaruar se Kosova ka politika sociale, 22.61 % e të anketuarve kanë deklaruar se Kosova nuk ka politika sociale, dhe 18.79 % e të anketuarve janë shprehur se nuk e dinë.


➤ *Si qytetar a jeni të kënaqur me shërbimet sociale në Kosovë?*



Grafiku 10.0 Kënaqësia e qytetarëve me shërbimet sociale në Kosovë.

Se a janë qytetarët e kënaqur me shërbimet sociale në Kosovë apo të pakënaqur, kemi të dhënat e paraqitura në grafikun 10.0 ku të anketuarit kanë deklaruar se 26.91 % e tyre se janë të kënaqur me shërbimet sociale në Kosovë, kurse 73.09% e të anketuarve kanë deklaruar se nuk janë të kënaqur me shërbimet sociale .


➤ *A mendoni ju se qeveria e Kosovës në shërbimet sociale ka bërë?*



Grafiku 11.0 Investimi nga qeveria (i ulët, mesatar, i lartë).

Në grafikun 11.0. kemi paraqitur rezultatet e studimit në lidhje me pyetjen se a mendojnë që qeveria e shtetit të Kosovës ka bërë investim të ulët, të mesëm apo të lartë, ku në grafikë vërejmë se 19.11 % e të anketuarve kanë deklaruar se qeveria ka bërë investim të lartë, investim të ulët me 7.80% dhe që në Kosovë për shërbime sociale ka investim të ulët kanë deklaruar 73.09 %.


➤ *Shërbimet sociale të mirëfillta të një vendi, a ndikojnë në cilësinë e jetës të qytetarëve?*



Grafiku 12.0 Ndikimi i shërbimeve sociale në cilësinë jetës së qytetarëve.

Në pyetjen e parashtruar qytetarëve të anketuar se shërbimet sociale të mirëfillta të një vendi, a ndikojnë në cilësinë e jetës të qytetarëve, nga grafiku 12.0. kemi të dhënat e marra nga mendimi i të anketuarve ku 6.06 % kanë deklaruar se shërbimet e mirëfillta nuk ndikojnë në cilësinë e jetës së qytetarëve dhe 93.94% (Përqind) e tyre kanë deklaruar se shërbimet e mirëfillta ndikojnë në cilësinë e jetës së qytetarëve.


➤ *Kush duhet të jetë përgjegjës për investimet në shërbimet sociale ?*



Grafiku 13.0 Përgjegjës për investimet në shërbimet sociale.

Kush duhet të jetë përgjegjës për investimet në shërbimet sociale, ku nga grafiku 13.0 kemi të dhënat që janë marrë nga studimi që tregojnë se vetëm 23 % e të anketuarve kanë deklaruar se përgjegjës për investimet në shërbimet sociale është pushteti lokal, kurse pjesa tjetër e mbetur , 77 % e të anketuarve kanë deklaruar se përgjegjës për investimet në shërbimet sociale është qeveria.


- *A ka miratuar shteti juaj një politikë, duke deklaruar se i mbron shërbimet sociale të vendit ?*



Grafiku 14.0 Miratimi i politikës nga shteti për mbrojtjen e shërbimeve sociale.

Nga grafiku 14.0 kemi të dhënat nga analiza e studimit që tregon për mendimin e qytetarëve të anketuar, ku 10.83 % mendojnë që shteti ka miratuar politikë që merret me mbrojtjen e shërbimeve sociale, 16.24 % e qytetarëve të anketuar mendojnë që shteti nuk ka ndonjë politikë që mbron shërbimet sociale dhe 72.93 % e qytetarëve të anketuar kanë deklaruar se nuk e dinë nëse ka ndonjë politikë që mbrohen shërbimet sociale .


➤ *Në cilat shërbime sociale mendoni që shteti ka investuar më shumë?*



Grafiku 15.0 Shërbimet sociale që ka investuar shteti më shumë.

Më lartë është paraqitur mendimi i qytetarëve në lidhje me se në cilat shërbime është investuar më shumë nga shteti, ku përqindje më të ulët të investimeve ka shërbimet e punësimit me 2.87 % në kujdesin afatgjatë 15.92 %, në kujdesin e fëmijëve 39.01 % dhe se përqindje më të lartë nga mendimet e qytetarëve se shteti ka investuar më shumë në shërbimet e strehimit social .


- *A ka vendi juaj institucione të pavarura që mirren me ruajtjen, zhvillimin dhe sigurimin e shërbimeve sociale në mënyrë financiare?*



Grafiku 16.0 Ekzistimi i institucioneve të pavarura që merren me ruajtjen, zhvillimin dhe sigurimin e shërbimeve sociale në mënyrë financiare.

Në grafikun 16.0. është paraqitur mendimi i qytetarëve në lidhje me ekzistimin e ndonjë institucioni të pavarur që merret me ruajtjen, zhvillimin dhe sigurimin e shërbimeve sociale në mënyrë financiare. Asnjë qytetar nuk ka deklaruar se ka ndonjë institucion të pavarur, 43.31 % nuk e dinë nëse ka ndonjë institucion të pavarur dhe se 56.69 % mendojnë që nuk ka ndonjë institucione të pavarura që merren me ruajtjen, zhvillimin dhe sigurimin e shërbimeve sociale në mënyrë financiare


➤ *Cila është arsye që Kosova ka pas ngecje me zhvillimin e shërbimeve sociale?*



Grafiku 17.0 Arsye e Kosovës në ngecje me zhvillimin e shërbimeve sociale.

Në grafikun 17.0. është paraqitur arsye, pse Kosova ka pas ngecje në zhvillimin e shërbimeve sociale . ku 14.26 % kanë deklaruar se arsye është mungesa e planifikimit strategjik në nivelin komunal. Me 12.02 % kanë deklaruar se arsye është mungesa e një plani afatgjatë për përmirësimin e shërbimeve sociale, me 24.04 %, arsye është mungesa e institucioneve të pavarura që merren me shërbimet sociale, me 16.03 % kanë deklaruar se arsye është menaxhimi jo i mirë i shërbimeve sociale në vend, me 14.42 % mungesa e stafit adekuat që merret me shërbimet sociale është njëra nga arsyet, me 12.48 %, arsye sipas qytetarëve është mungesa e përkushtimit politik ndaj sigurimit të shërbimeve sociale dhe se me 6.41 % , arsye që Kosova ka ngecje me zhvillimin e shërbimeve sociale është mungesa e qartësisë së marrëveshjeve për shërbime sociale .

➤ *Çka duhet të përmirësoj qeveria , që të kemi zhvillim në shërbime sociale ?*



Grafiku 18.0 Çka të përmirësoj qeveria që të kemi zhvillim në shërbimet sociale.

Në grafikun 18.0. kemi të dhënat nga qytetarët ku tregojnë se për të pasur zhvillim në shërbimet sociale duhet të përmirësohet gjetja e burimeve financiare që ndihmojnë në zhvillimin e shërbimeve financiare me 45 %, përkushtim politik ndaj sigurimit të shërbimeve sociale me 26%, qasje në ndihma teknike të jashtme për zhvillimin e shërbimeve sociale 12 %, krijimi i databazës, programe dhe materiale trajnimi për shërbimet sociale 17 %.

5.6. Përfundim nga Studimi Empirik

Gjatë studimit të opinionit të qytetarëve të shtetit të Kosovës për shërbimet sociale, vijmë në përfundim se pjesë e studimit ishin 46 % e gjinisë femërore dhe kurse të gjinisë mashkullore ishin 54 %, Përqindja më e lartë e moshës me 67.83 % që morën pjesë në studim është 36-45 vjeç, kurse për qindja më e ulët që morën pjesë është me 1.76 % e moshës mbi 46 vjeç.

84.23 % e qytetarëve të anketuar kanë arsimim të lartë dhe 24 % e qytetarëve të anketuar janë të papunë, 46 % të punësuar dhe 30 % e qytetarëve të anketuar janë student. 65.12 % e të hyrave familjare të qytetarëve të anketuar janë 201-400 euro në muaj . dhe se për qindja më e lartë e të anketuarve ishin nga qyteti i Prishtinës me 31.84 % e të anketuarve nga qyteti i Ferizajt 18.31 % dhe nga qyteti i Gjakovës me 8.12 % kurse qytetet tjera ishin pjesëmarrës në hulumtim me 35.67 %.

62 % e qytetarëve të anketuar të shtetit të Kosovës kanë dëgjuar për politikën sociale dhe mirëqenien, 38 % e tyre që kanë deklaruar se nuk kanë dëgjuar për politikën sociale dhe mirëqenien, mendojnë 100 % që shteti i Kosovës duhet të përdor, mjete të ndryshme që të informojë qytetarët për politikën sociale dhe mirëqenien.

58.60% e të anketuarve kanë deklaruar se Kosova ka politikën sociale por 73.09 % nuk janë të kënaqur me shërbimet sociale dhe pse 93.94 % e qytetarëve kanë deklaruar se shërbimet e mirëfillta ndikojnë në cilësinë e jetës së qytetarëve, mendojnë se përgjegjës për investimet në shërbimet sociale janë qeveria me 77 %, dhe investimi i qeverisë në shërbimet sociale në Kosovë është investim i ulët me 73.09 %. në përgjithësi investim më të lartë ka në strehimet sociale me 42.20 %, kurse investim më të ulët në shërbimet e punësimit me 2.87 %

Sipas të anketuarve 56.69 %, shteti i Kosovës nuk ka institucione të pavarura që merren me ruajtjen, zhvillimin dhe sigurimin e shërbimeve sociale në mënyrë financiare dhe 72.93 % e të anketuarve nuk e dinë nëse ka ndonjë politikë që deklaron se i mbron shërbimet sociale të vendit. Arsye e Kosovës në ngecje me zhvillimin e shërbimeve sociale, me 24.04 % është mungesa e institucione të pavarura që merren me shërbimet sociale dhe me 16.03 % kanë deklaruar se arsye është menaxhimi jo i mirë i shërbimeve sociale në vend. Dhe për të pasur zhvillim në shërbimet sociale duhet të përmirësohet gjetja e burimeve financiare që ndihmojnë në zhvillimin e shërbimeve financiare me 45 % dhe me 26 % përkushtim politik ndaj sigurimit të shërbimeve sociale.

Kapitulli -V- KONKLUDIME DHE REKOMANDIME

6.0. Hyrje

Ky kapitull ka për synim që të jap një përmbledhje të përgjithshme të këtij punimi, të përmbledh në pika më të rëndësishme materialin prej kapitulli të parë e deri te kapitulli i katër.

Objektivat e kapitullit –V-Konkludime dhe Rekomandime janë:

1. Konkludim i përgjithshëm për vërtetimin e hipotezave;
2. Konkludim i përgjithshëm nga literatura ;
3. Konkludim nga studimi empirik;
4. Rekomandimet;

6.1. Vërtetimi/Testimi i hipotezave

Kemi paraqitur hipotezat ku nga rezultatet e hulumtimit për shërbimet sociale, kemi të dhëna të mjaftueshme për testimin e hipotezave, për të pranuar apo refuzuar një hipotezë.

H₁-Shërbimet sociale të mirëfillta janë parakushtë për cilësinë e jetës së qytetarëve .

Nga përgjigjet e marra me anë të realizimit të hulumtimit, nga të dhënat në grafikun 10.0. kemi të dhëna të mjaftueshme për të konfirmuar këtë hipotezë, Pra shërbimet sociale të mirëfillta janë parakushte për cilësinë e jetës së qytetarëve dhe hipoteza e parë vërtetohet plotësisht e saktë .

H₂- Qytetarët nuk janë të kënaqur me shërbimet sociale.

Hipoteza e dytë është e konfirmuar nga të dhënat e marra nga hulumtimi të paraqitura në grafikun 0.0. vijmë në përfundim se qytetarët nuk janë të kënaqur me shërbimet sociale në shtetin e Kosovës.

H₃- Shteti nuk investon sa duhet në shërbimet sociale dhe se për investimet në shërbimet sociale duhet të jenë përgjegjësi e pushtetit lokal.

Në bazë të grafikës 11.0 kemi të dhënat nga përgjigjet e marra nga qytetarët e anketuar, për të vërtetuar se shteti nuk investon sa duhet në shërbimet sociale pasi që kanë deklaruar se shteti ka bërë investim të ulët dhe nga grafiku 13.0. rezultateve të marra nga hulumtimi, tregojnë se përgjegjës për investimin në shërbime sociale nuk është pushteti lokal, por përqindje më të lartë ka qeveria që duhet të jetë përgjegjës. Pra, Kjo hipotezë pjesërisht konfirmohet.

6.2. Konkludime të përgjithshme

Përfundimi i përgjithshëm vjen si rezultat i të dhënave të mbledhura, analizuara, nga rishikimi i literaturës dhe hulumtimi i tregut .

- ✚ Politikat sociale dhe mirëqenia zanafillën e ka qysh në kohën e hershme, në shekullin e VI-të. Dhe se fjala politikë sociale ka filluar të përdoret në të dyzetat e shekullit 19-të, në Gjermani ku Gustav Schmoller dhe Adolf Wagner kanë mbajtur një seancë për **“çështje sociale”**.
- ✚ Kemi shumë përkufizime të politikave sociale, mirëpo përkufizimet që përdoren më së shumti janë : **“Politika sociale** është studimi i shërbimeve sociale dhe të shtetit social. Politika sociale është një term që është aplikuar në fusha të ndryshme të politikës, zakonisht brenda një mjedisi qeveritar ose politik “ dhe **“Politika Sociale** është studimi i mirëqenies së njeriut, më konkretisht politika sociale përfshinë studimin e mardhënieve shoqërore të nevojshme për mirëqenien e njeriut dhe sistemet me të cilat mund të promovohet mirëqenia”.
- ✚ Politikat sociale luajn një rol shumë të rëndësishëm për një shtet, sepse përmirëson cilësinë e jetës së qytetarëve. Përmirëson Edukimin, Shtetësinë, Kulturën, Të ardhurat, Ekonomik, Resident në zonat rurale.
- ✚ Fjala mirëqenie është shumë e vështirë për tu kuptuar nga të gjithë dhe se mirëqenia shërben kryesisht interesave fizike dhe materiale të marrësit ku interesat janë të lidhura edhe me nevojat e njerëzve, të cilat janë të përcaktuara dhe me atë që njerëzit duan.
- ✚ Kemi dy lloje të mirëqenies : Mirëqenia Individuale dhe Mirëqenia sociale .

- ✚ Llojet e pensioneëve në Republikën e Kosovës janë :E Drejta në pension bazik të moshës ; E Drejta në pension të aftësisë së kufizuar; E Drejta në pension të parakohshëm; E Drejta në pension invalidor të punës; E Drejta në pension familjar ; E drejta në beneficion për pensionin bazik të moshës; E Drejta në beneficion për pensionin e parakohshëm;
- ✚ Llojet e Pensioneve të ofruar nga Republika e Shqipërisë janë :Pension Pleqërie; Pension pleqërie i reduktuar; Pension invaliditetit; Pension invaliditeti i pjesëshëm; Pension invaliditeti i reduktuar; Pensioni familjar; Të ardhura shtesë për kujdesje ; Të ardhura shtesë për fëmijën në ngarkim; Pagesë për vdekje;
- ✚ Pensionet ofrohen nga Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë për qytetarët që nuk janë të aftë të punojnë për arsye të ndryshme .Dhe se këto pensione nuk dallojnë për nga arsyea që përse ofrohen, por dallojnë nga politikat se si janë të formuluar këto pensione që ofrohen nga shteti për qytetarët e saj .
- ✚ Shërbimet sociale janë shumë të rëndësishme për mirëqenien e qytetarëve, pasi këto shërbime ofrohen nga ana e shtetit për qytetarët e saj, për plotësimin e nevojave, dhe për përmirësimin e cilësisë jetësore. Në Republikën e Kosovës Ligji nr.02/01-17, është ligjë që përcakton shërbimet sociale dhe familjare, ky ligj parasheh të gjitha shërbimet sociale familjare prej shërbimeve sociale për fëmijë e deri tek shërbimet sociale e të moshuarve. Ky ligj përfshinë ofrimin e drejtpërdrejt të përkujdesjes sociale, këshillimit ose në raste të veçanta, ndihmë material për njerëzit në nevojë sociale, kurse shërbimet shoqërore sipas ligjit Neni 6,. Ligj.Nr.9355, "Ligj për ndihmën dhe shërbimet sociale" përfshijnë shërbimet që u ofrohen, individëve, familjeve në nevojë,për plotësimin e nevojave të tyre jetësore.

✚ Shërbimet sociale në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, dallojnë për nga mënyra se si janë të formuluar këto politika. Në Republikën e Kosovës është Ligji i shërbimeve sociale dhe familjes Nr:02/01-17 që përfshinë të gjithë llojet e shërbimeve të ofruar, kurse në Republikën e Shqipërisë është Ligj për ndihmën dhe shërbimet sociale, nr 9355, datë 10.03.2005. Ku neni 6 i ligjit nr. 9355, paraqet përfituesit e shërbimeve sociale që i parasheh ky ligj. Dallimi tjetër është se neni 12 i ligjit për ndihmën dhe shërbimet sociale nr. 9355 i Republikës së Shqipërisë, parasheh ndarjen e shërbimëve sipas natyrës, në shërbime të përkujdesit shoqëror dhe në shërbime të përkujdesit shoqëror-mjekësor. Shërbimet sociale në Republikën e Kosovës, ofrohen prej entit social, kurse në Republikën e Shqipërisë ofrohet nga shërbimit social shtetëror (ISHSH), Shërbimi social shtetëror është institucion publik, në varësi të Ministrisë përgjegjëse për çështjet e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore. (Neni 26.Pika1, Ligj për ndihmën dhe shërbimet sociale). Dhe se ky institucion, i ndanë kategoritë e shërbimeve sociale : Për fëmijët, për të moshuar, për qendra zhvillimi dhe për qendra tranzitore të emërgjencave

6.3. Përfundim nga studimi empirik

Nga studimi për shërbimet sociale në shtetin e Kosovës, mbledhja e të dhënave nga përgjigjet e qytetarëve vijmë në përfundim se :

- ✚ Në studim morën pjesë 46 % e të anketuarve të gjinisë femërore, kurse 54 % të gjinisë mashkullore.
- ✚ Përqindja më e lartë e moshës me 67.83 % që morrën pjesë në studim është 36-45 vjeç, kurse përqindja më e ulët që morrën pjesë është me 1.76 % i moshës mbi 46 vjeç.
- ✚ 84.23 % e qytetarëve të anketuar kanë arsimim të lartë.
- ✚ 24 % e qytetarëve të anketuar janë të papunë, 46 % të punësuar dhe 30 % e qytetarëve të anketuar janë student.
- ✚ 65.12 % e të hyrave familjare të qytetarëve të anketuar janë 201-400 euro në muaj .
- ✚ Përqindja më e lartë e të anketuarve ishin nga qyteti i Prishtinës me 31.84 % e të anketuarve nga qyteti i Ferizajit 18.31 % dhe nga qyteti i Gjakovës me 8.12 %.
- ✚ 62 % e qytetarëve të anketuar të shtetit të Kosovës kanë dëgjuar për politikat sociale dhe mirëqenien.
- ✚ 38% e tyre që kanë deklaruar se nuk kanë dëgjuar për politikat sociale dhe mirëqenien, mendojnë 100 % që shteti i Kosovës duhet të përdor, mjete të ndryshëm që të informojë qytetarët për politikat sociale dhe mirëqenien.
- ✚ 58.60 % e të anketuarve kanë deklaruar se Kosova ka politika sociale.

- ✚ 73.09 % nuk janë të kënaqur me shërbimet sociale në Kosovë.
- ✚ Investimi i qeverisë në shërbimet sociale në Kosovë është investim i ulët me 73.09 %.
- ✚ 93.94 % e qytetarëve kanë deklaruar se shërbimet e mirfillta ndikojnë në cilësinë e jetës së qytetarëve.
- ✚ Përgjegjës për investimet në shërbimet sociale janë qeveria me 77 %.
- ✚ 72.93 % e të anketuarve nuk e dinë nëse ka ndonjë politikë që deklaron se i mbrosh shërbimet sociale të vendit.
- ✚ Investim më të lartë ka në strehimet sociale me 42.20 %, kurse investim më të ulët në shërbimet e punësimit me 2.87 % .
- ✚ Sipas të anketuarve 56.69 %, shteti i Kosovës nuk ka institucione të pavarura që mirren me ruajtjen, zhvillimin dhe sigurimin e shërbimeve sociale në mënyrë financiare.
- ✚ Arsye e Kosovës në ngecje me zhvillimin e shërbimeve sociale, me 24.04 % është mungesa e institucione të pavarura që mirren me shërbimet sociale dhe me 16.03 % kanë deklaruar se arsye është menaxhimi jo i mirë i shërbimeve sociale në vend.
- ✚ Dhe për të pasur zhvillim në shërbimet sociale duhet të përmirësohet gjetja e burimeve financiare që ndihmojnë në zhvillimin e shërbimeve financiare me 45 % dhe me 26 % përkushtim politik ndaj sigurimit të shërbimeve sociale.

6.4. Rekomandime

Duke parë se sa të rëndësishëm janë politikat sociale, shërbimet sociale për një shtet, dhe nga analiza e të dhënave vijnë në konkluzione, të cilat janë edhe rekomandime për qeverinë e Kosovës, që të mund ti merr si bazë për të luftuar problemet me gjendjen aktuale dhe në drejtim të përmirësimit të situatës sociale në Kosovë në të cilën gjendet në bazë të mendimit të qytetarëve.

- ✓ Rekomandoj që shteti i Kosovës duhet të përdorë ndonjë mënyrë që të informojë qytetarët e saj për politikat sociale dhe mirëqenien që kanë deklaruar të anketuarit në grafikun 8.0. dhe pasi që në grafikun 7.0. ku kemi 38 % të qytetarëve të anketuar që nuk kanë dëgjuar për politikat sociale dhe mirëqenien.
- ✓ Që qeveria të përdorë ndonjë metodë për të kuptuar që Kosova ka politika sociale pasi që në grafikun 9.0. qytetarët kanë deklaruar se Kosova nuk ka politika sociale dhe 18.79 % kanë deklaruar se nuk e dinë, që në të ardhmen qytetarët të deklarojnë që Kosova ka politika sociale.
- ✓ Qeveria duhet të ofrojë shërbime sociale të mirfillta në mënyrë që qytetarët që deklaruan në grafikun 9.0. me 73.09 % nuk janë të kënaqur me shërbimet sociale.
- ✓ Qeveria duhet të rritë investimin në shërbimet sociale, pasi që në grafikun 11.0. kemi të dhënat e mendimit të qytetarëve, ku me 73.09 % qeveria ka bërë investim të ulët në shërbimet sociale .
- ✓ Qeveria të vazhdojë të pranojë përgjegjësit që ka në lidhje me investimet në shërbimet sociale.
- ✓ Të miratojë politikat që mbrojnë shërbimet sociale të vendit .

- ✓ Shteti të investojë më shumë në shërbimet e punësimit , sepse sipas përgjigjeve të marra nga qytetarë në grafikun 15.10. ka investim me 2.87 %
- ✓ Shteti i Kosovës duhet të ketë institucione të pavarura që mirren me ruajtjen, zhvillimin dhe sigurimin e shërbimëve sociale në mënyrë financiare, se disa qytetarë kanë deklaruar se Kosova nuk i ka këto institucione me 56.96 % dhe disa nuk e dinë me 43.31 %, nëse Kosova ka institucione të pavarura. Dhe nëse shteti ka këto institucione t'i informojë qytetarët e saj për ekzistimin e tyre.
- ✓ Që Kosova të mos ketë ngecje në zhvillimin e shërbimëve sociale duhet që qeveria e shtetit të Kosovës të punësojë stafin adekuat për që merret me shërbimet sociale ku me 14.42 % kanë deklaruar se është kjo njëra arsye, dhe se arsyet tjera që kanë pasur përqindje më të lartë që duhet të merren si bazë për të përmirësuar gjendjen aktuale janë: mungesa e planifikimit strategjik edhe në nivelin komunal dhe menaxhimi jo i mirë i shërbimëve sociale në vend.
- ✓ Për të përmirësuar gjendjen aktuale dhe për të zhvilluar shërbimet sociale, qeveria duhet të ketë përkushtim politik ndaj sigurimit të shërbimëve dhe gjetjen e burimeve financiare që merren me zhvillimin e shërbimëve sociale.

6.5. Referencat

- ¹ **Martin Bellerman**, “Sozialpolitik”, Eine Einfuhrung fur sociale, Seite 15.
- ² **Historia e politikave social**, Enciklopedia e lirë-https://en.wikipedia.org/wiki/Social_policy
- ³ **Alison McClelland**, “What is Social Policy “, Sample Only, Oxford University Pres ANZ, Page 3.
- ⁴ **Dean.H**, Defenition of social policy as a field of study, (2006), chapter 1, page 8
- ⁵ **Spicker, Paul**. "*An introduction to Social Policy*". Retrieved 21 May 2015., edition 3,pp 9
- ⁶ **P.Spicker**, Social policy: theory and practice, Policy Press 2014. ` edition III,part1pp.6
- ⁷ "*Welcome to the Department*". *London School of Economics (LSE)*. Retrieved 21 May 2015.,
- ⁸ *Social Policy in Aotearoa New Zealand: A Critical Introduction* (2005) by Christine Cheyne, Mike O'Brien, & Michael Belgrave - Page 3
- ⁹ **Jose Vargas-Hernandez, Mohammad Reza Noruzi, Irani Farhad Nezhad Haj Ali**. What is Policy, Social Policy and Social Policy Changing?. *International Journal of Business and Social Science*, 2011, 2 (10), pp.288
- ^{10,11} **Paul Spicker** ” *Principles of social welfare*” an introduction to thinking about the welfare state, First published 1988 by Routledge, page 8.
- ¹² **Paul Spicker** ” *Principles of social welfare*” an introduction to thinking about the welfare state, First published 1988 by Routledge, page 8-10.
- ¹³ **Republika e Kosovës** “Strategjia për decentralizimin e shërbimeve ne Kosove (2013-2017), Zhvilluar nga komisioni këshillimor për politika për decentralizimin e shërbimeve sociale, Shtator 2012, faqe 7.
- ¹⁴ **Neni 2, Fushveprimi**- Për skemat pensionale të financuar nga shteti, Kuvendi i Republikës së Kosovës, faqe 2

¹⁵ **Neni 1, Qëllimi** - Për skemat pensionale të financuar nga shteti, Kuvendi i Republikës së Kosovës, faqe 1

¹⁶ **Neni 8, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Departamentit përkatës për pensione** - Për skemat pensionale të financuar nga shteti, Kuvendi i Republikës së Kosovës, faqe 10.

¹⁷ **Neni 4, Të drejtat e përcaktuara me këtë ligj** - Për skemat pensionale të financuar nga shteti, Kuvendi i Republikës së Kosovës, faqe 8.

¹⁸ **Neni 7, Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës për pensionin bazik të moshës**, Projekt ligji për skemat pensionale të financuar nga shteti, Republika e Kosovës, faqe 9-10.

¹⁹ **Neni 8, "Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension të aftësisë së kufizuar"** Projektligji për skemat pensionale të financuar nga shteti, Republika e Kosovës, faqe 11-12.

²⁰ **Neni 9, "Kushtet dhe kriteret për njohjen e së drejtës për pension të parakohshëm"** Projekt ligji për skemat pensionale të financuar nga shteti, Republika e Kosovës, faqe 13-14.

²¹ **Neni 10, "Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës për pension invalidor të punës"**, Projekt ligji për skemat pensionale të financuar nga shteti, Republika e Kosovës, faqe 15-16 .

²² **Neni 11, "Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës për pension familjar"**, Projekt ligji për skemat pensionale të financuar nga shteti, Republika e Kosovës, faqe 17-18.

²³ **Neni 12, "Beneficioni për pensionin bazik të moshës dhe pensionin e parakohshëm"**, Projektligji për skemat pensionale të financuar nga shteti, Republika e Kosovës, faqe 19-21

²⁴ **Neni 9, "Kushtet dhe kriteret për njohjen e së drejtës për pension të parakohshëm"**, Projekt ligji për skemat pensionale të financuar nga shteti, Republika e Kosovës, faqe 13-15.

Neni 12, "Beneficioni për pensionin bazik të moshës dhe pensionin e parakohshëm", Projekt ligji për skemat pensionale të financuar nga shteti, Republika e Kosovës, faqe 19- 21.

²⁵ **Instituti I sigurimëve Shoqërore** në zbatim të neneve 30-42 të kreut III-të, të ligjit Nr.7703, datë 11.05.1993.

²⁶ **KREU III, Neni 30, "PENSIONET"**, "Ligji për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, faqe 21-22.

²⁷ **KREU III, Neni 31, Ligji nr.7703.datë 11.05.1993** “*Pension Pleqërie*”, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,faqe 22.

²⁸ **KREU III, Neni 31/1, Ligji nr. 7703. datë 11.05.1993** “*Pension Pleqërie i reduktuar*”, “Ligji për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,faqe 22.

²⁹**KREU III, Neni 35**”Kushtet e përfitimit të pension invaliditetit, “Ligji për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,faqe 23..

³⁰ **KREU III, Neni 37,** ” Pensioni i invaliditetit të pjesshëm”, “Ligji për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë ”, të ndryshuar,faqe 24.

³¹ **KREU III, Neni 37/1,** ” *Pension i invaliditetit i reduktuar*”, “Ligji për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë ”, të ndryshuar,faqe 24.

³² **KREU III, Neni 38,** ” *E ardhura shtesë për kujdesje* ”, “Ligji për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë ”, të ndryshuar,faqe 24.

³³ **KREU III, Neni 39,** ” *E ardhura shtesë për fëmijë në ngarkim* ”, “Ligji për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë ”, të ndryshuar,faqe 24-25.

³⁴ **KREU III, Neni 40,** ” *Pension Familjar, Kushtet e Përfitimit*, “Ligji për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë ”, të ndryshuar,faqe 25.

³⁵ **KREU III, Neni 42,** ” *Pagesa për vdekje* , “Ligji për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë ”, të ndryshuar,faqe 26.

³⁶ **Neni 3,** “*Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare* “, *Ligji nr. 02/L-17,Prill 2005. faqe 1.*

³⁷ **Neni 1,** “*Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare* “, *Ligji nr. 02/L-17,Prill 2005. faqe 1*

^(38,-51) Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare, Nr.02/L-17,

Ligji për Familjen I Kosovës Nr:2004/32.

Intervista me Shyqyri Mehmeti drejtor i shërbimeve sociale.

⁵² **Kreu I-Neni 1,Ligji nr:9355,** *”Ligj për ndihmën dhe shërbimet sociale”*, datë 10.03.2005, faqe 17

⁵³ **Kreu I-Neni 2,Ligji nr:9355,** *”Ligj për ndihmën dhe shërbimet sociale”*, datë 10.03.2005, faqe 17

⁵⁴ **Kreu V- Neni 26, Ligji nr:9355,** *”Ligj për ndihmën dhe shërbimet sociale”*, datë 10.03.2005, faqe 25

⁵⁵ **Kreu V,Neni 27,Ligji nr:9355,** *”Ligj për ndihmën dhe shërbimet sociale”*, datë 10.03.2005, faqe 26

⁵⁶ **Kreu V Neni 28 Ligji nr:9355,** *”Ligj për ndihmën dhe shërbimet sociale”*, datë 10.03.2005,faqe 26

⁵⁷ **Neni 5,Ligji Nr.9355,** *”Ligj për ndihmën dhe shërbimet sociale”*,datë 10.03.2005,, Republika e Shqipërisë faqe 20

⁵⁸ **NENI 10,Ligji Nr.9355,** *”Ligj për ndihmën dhe shërbimet sociale”*,datë 10.03.2005,, Republika e Shqipërisë faqe 21

⁵⁹ **NENI 11 Nr.9355,** *”Ligj për ndihmën dhe shërbimet sociale”*,datë 10.03.2005,, Republika e Shqipërisë faqe 21

⁶⁰ **Neni 13. Ligj.Nr.9355, Pika 1.** *”Ligj për ndihmën dhe shërbimet sociale”*datë 10.03.2005,,Republika e Shqipërisë,faqe 22.

⁶¹ **Neni 12, Ligj.Nr.9355,** *”Ligj për ndihmën dhe shërbimet sociale”*, datë 10.03.2005,, Republika e Shqipërisë, faqe 21.

⁶² **IPSH, Shërbimet sociale të ofruara,** web; <http://www.sherbimisocial.gov.al/>

6.6.Shtojca

6.6.1. Pyetësor i studimit për shërbimet sociale në shtetin e Kosovës.

1. Gjinia juaj ?

- a) Femër
- b) Mashkull

2. Mosha juaj?

- A. 18-25 vjeç
- B. 26-35 vjeç
- C. 36-45 vjeç
- D. Mbi 46 vjeç

3. Arsimimi juaj?

- A. Arsimi fillor,
- B. Arsimi i mesmëm,
- C. Arsimi i lartë,

4. Statusi juaj i punës :

- A. I papunë,
- B. I punësuar,
- C. Student,

5. Të hyrat familjare :

- A. Deri në 200 euro në muaj;
- B. 201-400 euro ne muaj;
- C. 401-600 euro ne muaj;
- D. 601-800 euro në muaj;
- E. Mbi 800 euro ne muaj;

6. **Qyteti ku jetoni ?** Pyetje e hapur
7. **A keni ndegjuar për politikat sociale dhe mirëqenien ?**
A. Po,
B. Jo .
8. **Nëse jo, a mendoni që Sheti i Kosovës duhet të përdor, mjete të ndryshëm që të informoj qytetarët për politikat sociale dhe mirëqenien ?**
A. Po,
B. Jo .
9. **A mendoni që Kosova ka politika sociale ?**
A. Po,
B. Jo .
C. Nuk e di.
10. **Si qytetar a jeni të kënaqur me shërbimet sociale në Kosovë?**
A. Po,
B. Jo .
11. **A mendoni ju se qeveria e Kosovës në shërbimet sociale ka bërë?**
A. Investim të ulët,
B. Investim mesatar,
C. Investim i lartë .
12. **Shërbimet sociale te mirfillta të një vendi, a ndikojnë në cilësinë e jetës të qytetarëve?**
A. Po,
B. Jo .

- 13. Kush duhet të jetë përgjegjës për investimet në shërbimet sociale ?**
- A. Qeveria,
 - B. Pushteti lokal,
- 14. A ka miratuar shteti juaj ndonjë politikë, që deklaron se i mbrohet shërbimet sociale të vendit ?**
- A. Po,
 - B. Jo.
 - C. Nuk e di.
- 15. Në cilat shërbime sociale mendoni që shteti ka investuar më shumë?**
- A. Kujdesin e fëmijëve,
 - B. Kujdesin afatgjatë,
 - C. Shërbimet e punësimit dhe
 - D. Strehimit social.
- 16. A ka vendi juaj institucione të pavarura që mirren me, ruajtjen, zhvillimin dhe sigurimin e shërbimëve sociale në mënyrë financiare?**
- A. Po,
 - B. Jo .
 - C. Nuk e di.
- 17. Cila është arsyeja që Kosova ka pasqeruar me zhvillimin e shërbimëve sociale?**
- A. Mungesa e planifikimit strategjik në nivelin komunal,
 - B. Mungesa e një plani afatgjatë për përmirësimin e shërbimëve sociale,
 - C. Mungesa e institucione të pavarura që mirren me shërbimet
 - D. Menaxhimi jo i mirë i shërbimëve sociale në vend,
 - E. Mungesa e stafit adekuat që mirret me shërbimet sociale,
 - F. Mungesa e përkushtimit politik ndaj sigurimit të shërbimëve sociale .
 - G. Mungesa e qartësisë së marrveshjeve për shërbime sociale .
- 18. Çka duhet të përmirësojë qeveria ,që të kemi zhvillim në shërbime sociale ?**

- A. Gjetjen e burimëve financiare që ndihmojnë në zhvillimin e shërbimëve financiare.
- B. Përkushtim politik ndaj sigurimit të shërbimëve sociale.
- C. Qasje në dihma teknike të jashtme për zhvillimin e shërbimëve sociale.
- D. Krijimi i databazës, programe dhe materiale trajnimi për shërbimet sociale

6.6.2, Tabela e rezultateve nga studimi për shërbimet sociale (numri i të anketuarve, dhe të dhënat në përqindje).

1.Gjinia juaj?	%	Numri i të anketuarve
A. Femër	45.54 %	286
B. Mashkull	54.46 %	342
Gjithsej	100 %	628

2. Mosha juaj?	%	Numri i të anketuarve
A. 18-25	18.31 %	115
B. 26-35	12.10 %	76
C. 36-45	67.83 %	426
D. Mbi 46	1.76 %	11
Gjithsej	100.00 %	628

3. Arsimimi juaj?	%	Numri i të anketuarve
A. Arsimi fillor,	3.82 %	24
B. Arsimi i mesmëm,	11.95 %	75
C. Arsimi i lartë,	84.23 %	529
Gjithsej	100.00 %	628

4. Statusi juaj i punës ?	%	Numri i të anketuarve
A. I papunë,	24.20 %	152
B. I punësuar,	45.70 %	287
C. Student,	30.10 %	189
Gjithsej	100.00 %	628

5. Të hyrat familjare ?	%	Numri i të anketuarve
A. Deri në 200 euro në muaj	21.49 %	135
B. 201-400 euro në muaj	65.12 %	409
C. 401-600 euro në muaj	7.17 %	45
D. 601-800 euro në muaj	5.10 %	32
E. Mbi 800 euro në muaj	1.12 %	7
Gjithsej	100.00 %	628

6. Qyteti ku jetoni ?	%	Numri i të anketuarve
A. Prishtinë	31.84 %	200
B. Ferizaj	18.31 %	115
C. Gjakovë	8.12 %	51
D. Gjilan	2.07 %	13
E. Prizren	3.99 %	25
F. Qytetet tjera	35.67 %	224
Gjithsej	100.00%	628

7. A keni dëgjuar për politikat sociale dhe mirëqenien ?	%	Numri i të anketuarve
A. Po,	62.42 %	392
B. Jo .	37.58 %	236
Gjithsej	100.00 %	628

8. Nëse jo, a mendoni që shteti i Kosovës duhet të përdor, mjete të ndryshëm që të informojë qytetarët për politikat sociale dhe mirëqenien ?	%	Numri i të anketuarve
A. Po,	100 %	628
B. Jo .	0 %	0
Gjithsej	100 %	628

9. A mendoni që Kosova ka politika sociale ?	%	Numri i të anketuarve
A. Po,	58.60 %	368
B. Jo,	22.61 %	142
C. Nuk e di .	18.79 %	118
Gjithsej	100.00 %	628

10. Si qytetar a jeni të kënaqur me shërbimet sociale në Kosovë?	%	Numri i të anketuarve
A. Po,	26.91 %	169
B. Jo,	73.09 %	459
Gjithsej	100.00 %	628

11. A mendoni ju se qeveria e Kosovës në shërbimet sociale ka bërë?	%	Numri i të anketuarve
A. Investim të ulët,	73.09 %	459
B. Investim mesatar,	7.80 %	49
C. Investim i lartë .	19.11 %	120
Gjithsej	100.00 %	628

12. Shërbimet sociale te mirëfillta të një vendi, a ndikojnë në cilësinë e jetës të qytetarëve?	%	Numri i të anketuarve
A. Po,	93.94 %	590
B. Jo,	6.06 %	38
Gjithsej	100.00 %	628

13. Kush duhet të jetë përgjegjës për investimet në shërbimet sociale ?	%	Numri i të anketuarve
A. Qeveria,	77.39 %	486
B. Pushteti lokal,	22.61 %	142
Gjithsej	100.00 %	628

14. A Ka miratuar shteti juaj një politikë, duke deklaruar se i mbron shërbimet sociale të vendit ?	%	Numri i të anketuarve
A. Po,	10.83 %	68
B. Jo.	16.24 %	102
C. Nuk e di	72.93 %	458
Gjithsej	100.00 %	628

15. Në cilat shërbime sociale mendoni që shteti ka investuar më shumë?	%	Numri i të anketuarve
A. Kujdesin e fëmijëve,	39.01 %	245
B. Kujdesin afatgjatë,	15.92 %	100
C. Shërbimet e punësimit dhe	2.87 %	18
D. Strehimit social,	42.20 %	265
Gjithsej	100.00 %	628

16. A ka vendi juaj institucione të pavarura që merren me, ruajtjen, zhvillimin dhe sigurimin e shërbimeve sociale në mënyrë financiare?	%	Numri i të anketuarve
A. Po,	0 %	0
B. Jo,	56.69 %	356
C. Nuk e di.	43.31 %	272
Gjithsej	100.00 %	628

17. Cila është arsyeja që Kosova ka pas ngecje me zhvillimin e shërbimeve sociale?	%	Numri i të anketuarve
A. Mungesa e planifikimit strategjik në nivelin komunal,	14.26 %	89
B. Mungesa e një plani afatgjatë për përmirësimin e shërbimeve sociale,	12.02 %	75
C. Mungesa e institucione të pavarura që merren me shërbimet	24.04 %	150
D. Menaxhimi jo i mirë i shërbimeve sociale në vend,	16.03 %	100

E. Mungesa e stafit adekuat që merret me shërbimet sociale	14.42 %	90
F. Mungesa e përkushtimit politik ndaj sigurimit të shërbimeve sociale	12.82 %	84
G. Mungesa e qartësisë së marrëveshjeve për shërbime sociale	6.41 %	40
Gjithsej	100 %	628

18. Çka duhet të përmirësoj qeveria, që të kemi zhvillim në shërbime sociale?	%	Numri i të anketuarve
A. Gjetjen e burimeve financiare që ndihmojnë në zhvillimin e shërbimeve financiare.	44.59 %	280
B. Përkushtim politik ndaj sigurimit të shërbimeve sociale.	26.27 %	165
C. Qasje në ndihma teknike të jashtme për zhvillimin e shërbimeve sociale.	12.10 %	76
D. Krijimi i databazës, programe dhe materiale trajnimi për shërbimet sociale	17.04 %	107
Gjithsej	100.00 %	628